Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 11 (43). NENTOR 2009. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

AURORA GROUP

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet

Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

REFLEKSIONE

Një baladë e ditëve tona

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 7

PROFIL

Sarina, aty ku fillon e ardhmja!

Nga: **DEFRIM METHASANI** - FAQE 16

MJEDISI

Kriza mjedisore dhe sfidat e së ardhmes

Nga: **HAKI KOLA** - FAQE 5

HISTORI

Si i njoha Izet Dibrën dhe Faik Shatkun

Nga: **SAIMIR SHATKU** - FAQE 12

OPINION

Kufijtë e mendjes

Nga: **XHAFER MARTINI**

Shëtitorja kryesore e qytetit të Peshkopisë është nga më të bukurat e qyteteve tona në mbarë Shqipërinë. Por edhe ata që kanë parë qytete të huaja, e konsiderojnë atë shumë të bukur. E gjerë dhe e drejtë është kjo rrugë, në të dyja anët e të cilës ka blirë, që i japin qytetit një bukuri të veçantë. Në pranverë, kur blirët çelin, përhapet një aromë e këndshme që, bashkë me ajrin e freskët, ke dëshira ta thithësh thellë. Dikur, gjatë gjithë shëtitores, ka pas lulishte me bar të blertë dhe lule, që ia shtonin edhe më shumë bukurinë dhe ngjyrat qytetit. Sot kjo shëtitore ka emrin "Elez Isufi". I është ndërruar emri, por edhe simbolet. Kjo është e natyrshme. Nuk ka thënë kot një i ditur që, nëse hiqni bustet dhe përmendoret, i lini piedestalet.

Pas çlirimit, në Peshkopi u vendosën bustet e Gjok Doçit dhe Nazmi Rushitit, i pari në shëtitoren kryesore, kurse i dyti në sheshin e ish-shkollës bujqësore të këtij qyteti. Këta ishin djem të rinj që e meritonin nderimin që iu bë, pavarësisht se ideali për të cilin ranë, nuk rezultoi që t`i sillte popullit tonë progres dhe lumturi. Megjithëse vetë ishin të pastër, mbi ta vetvetiu binin mëkatet e sistemit politik. Bustet e tyre krijonin një farë alergjie te shumica e njerëzve, mbasi linin të kuptohej se historia e këtij kombi dhe e këtij qyteti fillonte me "epokën e partisë". Për këto arsye, ndonëse nuk u hoqën, ato u bënë të kontestueshëm. Përmbysjet e mëdha në jetën e një kombi sjellin pashmangshmërisht ndryshime të tilla.

Në vitet e demokracisë, në krye të kësaj shëtitoreje, para ndërtesës së këshillit të rrethit, u vu busti i Elez Isufit. Nuk shtrojmë pyetjen nëse e meritonte apo jo kjo figurë atë vend.

(Vijon në faqen 2)

"Institucionet reagojnë pas shkrimit në gazetën "Rruga e Arbërit"

"Rruga do të jetë 10.5 metra e gjerë"

Inxhinierët e firmës "InfraTransProjec" ekskluzivisht për gazetën sjellin detaje të gjurmës së rrugës së Arbërit, urës së madhe mbi Urën e Vashës dhe tunelit të Murrizës.



Sipas projektuesve rruga në segmentin në fjalë, Ura Vashës - Tuneli Murrizës, ka një gjatësi prej rreth 13 kilometra. Në pjesën e parë të saj, në afërsi të Urës së vjetër të Vashës, ajo kalon në një terren tejet të aksidentuar malor, derisa ndërpret Lumin Mat, në një vend që është më i përshtatshëm për kapërcimin e luginës me urë, në vendin më të ngushtë të shtratit të lumit. Ura e re parashikohet të ketë një gjatësi prej 285 metra dhe do të jetë rreth 138 metra më lart nga shtrati i lumit. "Në këtë kuptim ajo do të jetë ura më e lartë dhe me hapësira më të mëdha e ndërtuar ndonjëherë në vendin tonë. Ajo do të projektohet dhe ndërtohet si një urë e tipit "Kantilever", siç quhet në terminologjinë e teknikës së urave. Të tilla ura nuk janë ndërtuar dhe projektuar ndonjëherë në vendin tonë. Kushtimi vetëm i kësaj ure do të jetë rreth 1.6 miliardë lekë ose rreth 11.7 milionë euro", thonë inxhinierët e firmës "InfraTransProjec".

LEXONI NE FAQEN 3

SHËNIME NË ÇADËR

Kur kërkonim minerale rrëzë Malit të Korabit

Nga: **VESEL HOXHA** - FAQE 10-11

BOTIME

Agron Tufa sjell katër libra të rinj

FAQE 8

MONOGRAFI

Lutfi Hanku boton librin "Marsi i vrarë"

Nga: **ZEJNEL SULA** - FAQE 9

Kufijtë e mendjes

A mund të rrinë bashkë në një copë shëtitore tërë këto vepra skulpturore? Shpërndarja e tyre në tërë trevën e Dibrës do të ishte më e këshillueshme, më shkencore dhe më kulturore. Heroin nuk e bën të lavdishëm e të rëndësishëm vendi ku e vendosin. Ndodh e kundërta: heroi e bën të përmendur vendin ku vendoset.

(Vijon nga faqja 1)

Ky shkrim nuk ka objekt gjykimin e asnjërës prej figurave që do të përmenden. Nuk ka rëndësi se kush e mori iniciativën, si u procedua deri në veprimin përfundimtar. Rëndësi ka fakti që vënia e bustit të Elez Isufit është aprovuar nga këshilli bashkiak, që e ka në kompetencë këtë detyrë. Këshilli bashkiak është pluralist dhe përfaqëson të gjitha interesat e pikëpamjet e njerëzve e të subjekteve politike që e kanë formuar këtë forum. Pra, pavarësisht nga pikënisjet për këtë apo atë figurë, veprimi përfundimtar është institucional.

Pas vënies së bustit që përmendëm, po në këtë shëtitore u vendos një bust tjetër, ai i Halil Alisë, një figurë shumë e diskutueshme në historinë e popullit tonë. Në këto vite të demokracisë kanë dalë shumë figura të reja të kombit tonë që në të kaluarën nuk njiheshin ose anatemoheshin nga diktatura komuniste. Me gjithë kundërshtimet e një pjese të mirë të mendimit dhe opinionit, ato janë rehabilituar në rrugë institucionale. Kështu ndodhi edhe me Halil Alinë. Në ditën e përurimit të bustit, përfaqësuesi i pushtetit vendor që foli me atë rast, duke ditur kompleksitetin e kësaj figure, tha një fakt interesant: vënia e këtij busti u miratua me unanimitet nga të gjithë anëtarët e forumit të instancës përkatëse. Në këtë përurim pati shumë njerëz, por, sigurisht, ata që nuk e kanë dashur vënien e bustit të Halil Alisë në atë vend, nuk morën pjesë. Megjithatë, ata ishin të përfaqësuar në forumin përkatës që mori atë vendim. Këto janë rregullat e demokracisë. Nuk ka mënyrë tjetër më të mirë.

Më vonë pranë bustit të Elez Isufit u vendos busti i atdhetarit të njohur Iljaz pashë Qoku., që ka një veprimtari të madhe atdhetare, sidomos si kryetar i parë i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Më në fund,(megjithëse fundi nuk dihet!), u vendos afër busteve të Elez Isufit dhe Iljaz pashë Qokut, përmendorja e Skënderbeut, e sponsorizuar nga biznesmeni Zaim Korsi dhe e realizuar nga skulptori Sadik Spahiu. Pa u marrë me gjykimin e figurave, lindin disa probleme të një karakteri tjetër.

Së pari, a mund të rrinë bashkë në një copë shëtitore tërë këto vepra skulpturore? Shpërndarja e tyre në tërë trevën e Dibrës do të ishte më e këshillueshme, më shkencore dhe më kulturore. Heroin nuk e bën të lavdishëm e të rëndësishëm vendi ku e vendosin. Ndodh e kundërta: heroi e bën të përmendur vendin ku vendoset. Nuk do t`i bëhej, fjala vjen, më shumë nder shkrimtarit Bajram Hyseni sikur emrin e tij ta kishte marrë një shkollë e mesme e kryeqytetit, sesa shkolla e vogël e vendlindjes që ngrihet modeste në një kodrinë të bleruar të fshatit Laçes. Në gjithë botën praktikohet që figurat e mëdha të njerëzimit të përjetësohen e të nderohen, në vendet e tyre të lindjes, dhe në vendet ku kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre.

Figurat e përmendura më lart, si lloj arti, janë të njëjta: vepra skulpturore. Po ato janë të njëjta edhe në një pamje tjetër: janë të gjithë njerëz të shpatës dhe të pushkës, çka flet për një koncept tradicionalist për heroin që shikohet vetëm si luftëtar. Po Dibra ka pasur edhe njerëz të shquar të fushave të tjera që mund t`u ngrihen buste e përmendore, por edhe mund të përjetësohen në forma të shumta të artit dhe të kujtesës së njerëzimit.

Së dyti, figurat e përmendura më lart, si lloj arti, janë të njëjta: vepra skulpturore. Po ato janë të njëjta edhe në një pamje tjetër: janë të gjithë njerëz të shpatës dhe të pushkës, çka flet për një koncept tradicionalist për heroin që shikohet vetëm si luftëtar. Po Dibra ka pasur edhe njerëz të shquar të fushave të tjera që mund t`u ngrihen buste e përmendore, por edhe mund të përjetësohen në forma të shumta të artit dhe të kujtesës së njerëzimit. Filozofët dhe mendimtarët, si: Seit Najdeni, dom Nikollë Kaçorri, Vehbi Dibra; shkrimtarë si Haki Stërmilli, Faik Ballanca, Bajram Hyseni; studiues si Haki Sharofi; piktor, si: Bajram Mata, muzikantë, si: Muharrem Xhediku, Munir Shehu, artistë popullorë si Haziz Ndreu, Liri Rasha etj., mund të përjetësohen në vepra artistike të llojeve të ndryshme. Nuk është e thënë që për secilin të ngrihet bust, por të përdoren edhe forma të tjera nderimi dhe përjetësimi, si: odat ose shtëpi muze, zakonisht shtëpitë ku kanë lindur, pllakat përkujtimore në vendet ku kanë zhvilluar aktivitetin, studiot ku kanë punuar, stenda të veçanta në muzeun historik të rrethit, vënia e emrave të tyre rrugëve, shesheve, objekteve të rëndësishme etj., etj. Një qytet, që të rrezatojë kulturë dhe të tregojë histori, nuk duhet të ketë vetëm buste.

Së treti, Dibra e Madhe dhe qyteti i Peshkopisë, sot, në kohën e demokracisë dhe të integrimeve euroatlantike, në mos për shumë gjëra, në fushën e kulturës dhe të artit, të gjuhës, të historisë etj., duhet t`i koordinojnë punët dhe veprimet. Ne kemi një gjuhë, një kulturë, një histori, një traditë etj, por, kur vjen puna në praktikë, nuk kemi bashkëpunimin e nevojshëm për t`i koordinuar vlerat historike dhe artistike që ato të shënojnë një vazhdimësi, duke eliminuar përsëritjet dhe paralelizmat e panevojshëm. Mund të jepnim edhe ndonjë shembull, që e përligj këtë shqetësim, por nuk është vendi. Kemi ëndërruar për zhdukjen e kufijve. Ato tashmë nuk kanë rëndësinë që kishin dikur. Puna është të mos i krijojmë vetë, me padijen tonë dhe me të metat në organizim. Kufijtë e mendjes janë më të këqij dhe më të pakalueshëm sesa telat me gjemba.

XHAFER MARTINI



Në foto: Shtatorja e Skënderbeut në qytetin e Peshkopisë. Lart bustet e Elez Isufit, Iljaz Pashë Qokut dhe Halil Alisë. Fotot. B.Karoshi

Dibra e Madhe dhe qyteti i Peshkopisë, sot, në kohën e demokracisë dhe të integrimeve euroatlantike, në mos për shumë gjëra, në fushën e kulturës dhe të artit, të gjuhës, të historisë etj., duhet t`i koordinojnë punët dhe veprimet....
...Kemi ëndërruar për zhdukjen e kufijve. Ato tashmë nuk kanë rëndësinë që kishin dikur. Puna është të mos i krijojmë vetë, me padijen tonë dhe me të metat në organizim. Kufijtë e mendjes janë më të këqij dhe më të pakalueshëm sesa telat me gjemba.

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 11 (43). 1- 30 Nëntor 2009

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Isa Halilaj, Mahmud Hysa, Rexhep Ndreu, Xhelal Roçi, Abdurahim Ashiku, Beqir Sina, Fatmir Minguli, Odise Plaku, Kujtim Boriçi, Dukagjin Hata, etj, se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Bashkëpunuan në këtë numër:
Xhafer MARTINI
Abdurahim ASHIKU
Beqir SINA
Zaim ELEZI
Ymer KETA
Defrim METHASANI
Zejnel SULA
Alma MILE
Vesel HOXHA
Saimir SHATKU
Ali KOÇEKU
Xheladin ÇELMETA
Dukagjin HATA
Haki Kola
Isuf SALLA
etj.

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë



Në foto: Gjurma e Rrugës së Arbërit nga Ura e Vashës në tunelin e Murrizës. Poshtë: Prerja tërthore e tunelit. (Foto.InfraTransProjec)

"Institucionet reagojnë pas shkrimit në gazetën "Rruga e Arbërit"

Ministri Olldashi: Rruga do të jetë 10.5 metra e gjerë

Nga: **BUJAR KAROSHI**

Pas shkrimit në gazetën "Rruga e Arbërit" kanë reaguar institucionet qendrore. Më datë 10 nëntor 2009, Ministri i Transporteve z. Sokol Olladashi ka theksuar në komisionin parlamentar të veprimtarive prodhuese, pas interesimit të deputetit të Dibrës, Jemin Gjana, se "Rruga e Arbërit nuk do të jetë më e ngushtë sa është deklaruar më parë. "Do të ndryshojmë në kualitetin e rrugës, e cila në segmentin e parë të vet është bërë me 9 metra, por do të ndryshojmë kualitetin e rrugës, duke konsideruar një korridor të rëndësishëm, do ta bëjmë nga 9 metra në 10.5 metra, për ti dhënë korridorit një formë të plotë", theksoi Sokol Olldashi, ministër i Transporteve.

Në mes të nëntorit, është bërë një mbledhje tjetër në Këshillin Teknik në Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, ku është njoftuar drejtuesi i punës së projektit Teknik, Ing. Faruk Kaba, për të vazhduar punën me projektin e 9 metra rrugë të asfaltuar ose 10.5 m në total.

I pyetur nga gazeta mbi ecurinë e projektit, Ing. Faruk Kaba, drejtuesi i firmës "InfraTransProjec" tha se po punonte mbi një projekt modern të Rrugës së Arbërit. Ai u shpreh i gatshëm që në këtë numër të gazetës të tregonte disa detaje interesante mbi projektin e rrugës dhe për këtë vendosi në dispozicion një grup inxhinierësh të firmës për të dhënë më shumë informacion. Përsa i përket ndryshimeve në projekt të folura më parë, Kaba tha se tani gjithçka ka marrë për mbarë dhe po punohet që në të ardhmen Rruga e Arbërit të jetë një nga rrugët më moderne në vend".

"Segmenti rrugor nga Bulqiza deri tek Ura e Vashe, pjesë e rëndësishme e Rrugës së Arbërit, që ka filluar të ndërtohet dhe veçanërisht segmenti nga Ura Vashës deri tek hyrja nga Tirana e tunelit të Murrizës, kanë qenë dy segmente të vështirësisë së shkallës së lartë të projektit të kësaj rruge", thotë njëri nga inxhinierët firmës "InfraTransProjec". "Duke trajtuar segmentin Ura Vashes-deri tek Tuneli i Murrizës, përfshi këtë tunel të vështirë, mund të themi se grupi i projektimit ka qënë i detyruar të zgjidhe probleme inxhinierike të vështira dhe shumë të vështira, ku veçohet Ura e re e Vashës dhe Tuneli i Murrizës".

Sipas projektuesve rruga në segmentin në fjalë, Ura Vashës - Tuneli Murrizës, ka një gjatësi prej rreth 13 kilometra. Në pjesën e parë të saj, në afërsi të Urës së vjetër të Vashës, ajo kalon në një terren tejet të aksidentuar malor, deri sa ndërpret Lumin Mat, në një vend që është më i përshtatshëm për kapërcimin e luginës me urë, në vendin më të ngushtë të shtratit të lumit. Ura e re parashikohet të ketë një gjatësi prej 285 metra dhe do të jetë rreth 138 metra më lart nga shtrati i lumit. "Në këtë kuptim ajo do të jetë ura më e lartë dhe me hapësira më të mëdha e ndërtuar ndonjëherë në vendin tonë. Ajo do të projektohet dhe ndërtohet si një urë e tipit "Kantilever", siç quhet në terminologjinë e teknikës së urave. Të tilla ura nuk janë ndërtuar dhe projektuar ndonjëherë në vendin tonë. Kushtimi vetëm i kësaj ure do të jetë rreth 1.6 miliardë lekë ose rreth 11.7 milionë euro", thonë inxhinierët e firmës "InfraTransProjec".

"Pas kësaj rruga vazhdon në ngjitje duke kaluar pranë fshatit Fshat të Matit, ku terreni i thyer dikton kalimin me një tunel me gjatësi rreth 600 metra. Tuneli kalon në formacione të "shëndosha" gjeologjike. Ai do të jetë me të gjithë infrastrukturën e nevojshme si ndriçim, siguri ndaj zjarrit, drenazhime, sinjalistikë speciale etj. Ky tunel, duke qenë më i shkurtër se 1 000 metra, sipas standardeve europiane, nuk ka nevojë për ventilim artificial".

Shpejtësia e projektuar e rrugës do të jetë jo me pak se 60 kilometra në orë, në pjesë të kufizuara dhe mbi 80 kilometra në orë në pjesën më të madhe të saj. Në këtë kuptim, gjerësia e rrugës do të jetë 10.5 deri 11.0 metra, ndërsa gjerësi e asfaltit do të jetë 9.0 metra, shume komode për lëvizjen me shpejtësirat e lartpërmendura në të gjithë rrugën. "Madje, përvoja tregon se me këto parametra do të vozitet pa problem deri në 100 kilometra në orë".



"Më tej rruga vazhdon gjatë luginës së lumit të Mashnorit, degë e lumit Mat, dhe kalon pranë fshatrave të bukur Shkallë dhe Xibër të Matit, në një terren, që sa vjen e bëhet më tërheqës, por edhe më i aksidentuar. Rreth 9 kilometra nga Ura Vashës rruga hyn në një tunel tjetër: më i gjati dhe më i rëndësishmi i rrugës së Arbërit, në tunelin e Murrizit. Gjatësia e tij nga matjet paraprake rezulton 3 520 metra. Tuneli, në dy hyrjet e tij, nga Tirana dhe nga Klosi, kalon në formacione tejet të vështira nga pikëpamja gjeologjike. Për këtë inxhinierët projektues janë të detyruar të marrin masa inxhinierike speciale, që po parashikohen në projekt zbatimin e këtij tuneli. Ashtu si dhe tuneli i mëparshëm dhe tuneli i Qaf Bullit, tashmë i projektuar dhe i përgatitur për tenderim për ndërtimin e tij edhe tuneli i Murrizit do te ketë të njëjtët parametra gjerësie dhe lartësie. Ai gjithashtu do të jetë i kompletuar me të gjithë infrastrukturën si ndriçim, siguri ndaj zjarrit, ventilim, drenazhime, telefoni etj."

Praktikisht, me ndërtimin e rrugës së Arbërit, Klosi shkurton distancën me Tiranën në rreth 70 kilometra dhe nga 109 kilometra bëhet vetëm 39 kilometra, ndërsa Burreli nga 92 kilometra bëhet vetëm 55 kilometra.

"Rruga në segmentin nga Ura e Vashës deri në Tunelin e Murrizit do të jetë e plotësuar me të gjitha veprat e artit, që nga ato të vogla, tombino e drenazhe të thjeshta, kuneta, kanale të veshur me beton etj., deri tek urat dhe viaduktet. Ndër këto dallohen 4 viadukte, që mendohet për të tejkaluar depresionet, që krijohen nga trasimi i rrugës në flaje. Në këtë rrugë, ashtu si në segmentin nga Bulqiza deri tek Ura e Vashës do të përfshihet edhe teknologjia e re e "dherave të armuar", të cilat përdoren në rastin e skarpatave të larta dhe tepër të larta në mbushje dhe në disa raste edhe për të shmangur ndërtimin e veprave të artit si mure apo viadukte."

"Vështirësi e zgjidhjes së kësaj rruge, veçanërisht e këtij segmenti, ka qenë kalimi në pika të detyruara si Ura e Vashës, tuneli i vogël, tuneli i madh i Murrizit, lugina e lumit të Mashnorit etj, të cilat kanë diktuar edhe alinjamentin gjatësor të rrugës, pjerrësitë e saj", thonë inxhinierët projektues. "Sigurisht këtu është patur parasysh edhe ekuilibri ndërmjet mundësisë së projektimit të rrugës me elemente gjeometrike sa më të mirë (planimetri dhe profil gjatësor) dhe kostos së ndërtimit të rrugës".

Projektuesit e kanë patur parasysh, që ky raport kosto/cilësi të anoje në favor të cilësisë së rrugës. Shpejtësia e projektuar e rrugës do të jetë jo me pak se 60 kilometra në orë, në pjesë të kufizuara dhe mbi 80 kilometra në orë në pjesën më të madhe të saj. Në këtë kuptim, gjerësia e rrugës do të jetë 10.5 deri 11.0 metra, ndërsa gjerësi e asfaltit do të jetë 9.0 metra, shume komode për lëvizjen me shpejtësirat e lartpërmendura në të gjithë rrugën. "Madje, përvoja tregon se me këto parametra do të vozitet pa problem deri në 100 kilometra në orë".

"Një veçanti e rrugës do të jetë edhe plotësimi i saj me rripa shtesë kalimi në pjesët e rrugëve me pjerrësi mbi 6 përqind, për të lehtësuar kalimin e mjeteve të lehta dhe për të mos penguar kalimin e tyre nga mjetet e renda me ngarkesë. Në çdo dy kilometra do të ketë edhe shesh pushime edhe këto për të rritur sigurinë rrugore dhe për të krijuar mundësi për mjetet që mund të ndalojnë, për të mos i krijuar vështirësi atyre që vazhdojnë lëvizjen", thonë projektuesit.

Ky segment, nga Ura Vashës deri në Murrizë-Tunel, do të ketë edhe dy kryqëzime, njëri me rrugën lidhëse që vjen nga Burreli dhe Klosi, si lidhje me rrugën nacionale egzistuese dhe tjetri me rrugën e fshatit Gur i Bardhë, për të siguruar lidhjet respektive të këtyre qendrave. Si dhe e gjithë rruga edhe ky segment dhe në veçanti edhe kryqëzimet do të jenë të plotësuar me të gjithë sinjalistikën më moderne bashkëkohore si ajo horizontale (vizimet) ashtu dhe ajo vertikale.

"Në tërësinë e këtij projekti përfshihet edhe lidhja e Rrugës së Arbërit me Klosin dhe me të gjithë rrjetin rrugor nacional në tërësi dhe Luginën e Matit në veçanti, për t'i shërbyer sa më mirë edhe këtij rajoni të rëndësishëm. Praktikisht, me ndërtimin e rrugës së Arbërit, Klosi shkurton distancën me Tiranën në rreth 70 kilometra dhe nga 109 kilometra bëhet vetëm 39 kilometra, ndërsa Burreli nga 92 kilometra bëhet vetëm 55 kilometra. Lidhja e Klosit me Rrugën e Arbërit, përbën një segment krejt të ri me gjatësi 3.0 kilometra, i cili kalon pjesërisht në një terren shume të aksidentuar dhe pjesërisht në një terren më pak të aksidentuar. Në ndërtimin e tij është parashikuar dhe një viadukt me gjatësi 60 metra dhe lartësi rreth 15 metra".

Rruga në këtë segment prej rreth 16 kilometrash, ku përfshihet edhe lidhja me Klosin, parashikon volume të konsiderueshme punimesh si: lëvizje dherash 2. 9 milionë metra kub, asfaltobetone 67 mijë ton, betone 68 mijë metra kub, hekur 5 328 ton dhe materiale shtresash (inerte, gurë te thyer) 147 mijë metra kub etj.. Kostoja paraprake e ndërtimit të këtij segment, përfshi dhe lidhjen me Klosin është rreth 30 miliardë lekë dhe në këtë kuptim është segmenti më i kushtueshëm i të gjithë rrugës. Zërin kryesor në këtë kosto e zë tuneli i Murrizit me një kushtim prej afro 14 miliard lekë ose rreth 100 milionë euro, që do të saktësohet në projektzbatimin e plotë të tij.

Grupi i projektuesve të këtij seksioni po punon me intensitet për përfundimin sa më parë të projektit të kësaj vepre të rëndësishme kombëtare.

Rruga Arbërit nr. 43

Nënë Tereza u tradhëtua nga kolegët e saj fetarë, kur ajo ndau me ta që dyshimet e saj rreth besimit në Zotin, sipas një studimi të ri të kryer nga akademikët e Universitetit të Birmingamit.

vështrime

Kohë dumdumesh

Nga: **ZAIM ELEZI**

-E mos më rrini ashtu të hutuar, e si njerëz të dorës së dytë, mbajeni mend, jeni shtresa më e rëndësishme e shoqërisë sot për sot. Pa ne shoqëria është e vdekur. Mbani kokën lart, mos ja dini për asnjë, as për më të bukurin, sepse ato që ju shihni të rehatohen në makina luksoze e të shtrenjta pa një vlerë janë, e kanë vënë paranë me pisllëqe, të jeni të sigurtë, me gjëra të ndyra. Ku e ku janë me ne, hapen b... kot, nga që nuk ka shtet, prandaj livadhisin.

Kishte marrë zjarr e nuk ndalej kryetari i dumdumsave, i kishte vënë përpara të gjithë sa ishin në sallë, pasi kishte kuptuar se po i rrëshqiste situata nga dora, po i dilte jashtë kontrollit.

Ç'është e drejta edhe ishin shtuar shumë, në dy hapa e gjen pa frikë një ose dy dumdumë. Janë mjetet më të veçanta në rrugë, më të çuditëshmit, ai që i ka krijuar ka qenë fantastik. Të gjithë vetëm një ngjyrë kanë e një formë, ndryshon vetëm numri i gomave të pasme, asgjë tjetër.Zemra mal të bëhet kur i sheh të rreshtuar për punë, si taborr karkalecash, për të shfarosur ara të pafund me të mbjella. Të qartë, të vendosur, të bindur në kauzën e tyre, e që mezi presin t'a realizojnë.

- Dy dumdumsa ishin rrahur për punë pune, njëri i kishte marrë klientin tjetrit. Nuk po i përmend me emër por rasti i atyre që u rrahën ditën për diell e faqe të gjithëve, - vazhdoi kryetari, është jo vetëm i shëmtuar por edhe i dënueshëm. Na ka dëmtuar shumë në opinion, duke krijuar idenë se dumdumsat "qenkan të pa edukuar e njerëz mali, vetëm zori të detyron të punosh me ne", e të tjera broçkulla pa fund. Ne vërtet vonë kemi zbritur në qytet, por ama, jo vetëm që jemi rregulluar me shtëpi e të tjera si këto, por na kanë zili sepse ne punojmë dhe nxjerrim lekun nga toka. Ky opinion është shërbimi më i keq që na bëhet ne e familjeve tona. Me këtë terezi do na lini pa punë e do përfundojmë tek këmbët e urës të gjithë, mbajeni mend mirë këto që po ju them, verini vath në vesh! Mos të ndodh më kjo! – shkrofëtinte ai.

Të gjithë heshtnin. Dumdumsat dukeshin se përpinin çdo fjalë që dilte nga goja e kryetarit. Zakonisht nëpër mbledhje ka mjaft që dremisin, por aty as që bëhej fjalë, i kishin bërë sytë na e nuk linin asnjë fjalë të binte përtokë. Vetëm njëri i kish ikur asaj mbledhje të rëndësishme, e veç trupin aty e kishte. Akrepat rendnin nxitimthi drejt orës së takimit. -Më vonë t'a kisha lënë dreqin, më duket se po vonohem. Do jem në krahët e zemrës sime, ngjitur pas meje, do ndjej aromën e trupit të saj, zemrën që i rreh e gufon. Po sytë gjithë shkëlqim që i pulit o Zot, o Zot si një mackë e vogël e lozonjare. Temperatura në gjoks po i rritej e më e vështirë përmbajtja po i bëhej. Kur e nxjerr kokën në dritaren e dumdumit e flokët ja llaston era, enkas për të më ndezur mua... - humbur në mendime ndjente të përflakej e sa më shumë e sillte në kujtesë atë, aq më të pakuptimta i dukeshin fjalët e kryetarit, të pa arësyeshme e krejt pa vend. Ç'hall kishte ai e ç'gjepura përralliste kryetari. Sapo linte punën, vrap e në punën e saj. E kishte të përditëshme. Ajo hop në dumdum pranë tij, e shkonin në qoshen e tyre që e kishin sajuar për të shijuar mrekullitë e dashurisë. Kohët e fundit kishte vënë re se ajo nuk e kishte shumë me qef të vinte me dumdum. Disa herë e kishte hedhur fjalën për makinat e bukura e luksoze që i parakalonin e iknin fluturim. Ai përpiqej e këmbën ja vinte në fund gazit, e një shtëllungë të madhe tymi linte pas, e prapë aq e kishte takatin ky dreq dumdumi. Sa e vuante të kishte një makinë të hajrit, shumë.

-Mos u ndjeni keq asnjëherë kur të ndesheni me punonjësit e administratës, bie fjala, -e shkundën fjalët e kryetarit. Nuk janë më të mirë se ne ato, -vazhdoi ai. I vetmi ndryshim është se ato punojnë në zyrë. Unë dua t'ju them ju, se nëqoftëse shkoni vetëm një ditë për të zgjidhur një hall apo një problem në dyert e zyrave të tyre, do shihni se janë si ne e mos më keq. Për vete sa herë detyrohem të shkoj, bindem se janë shumë më poshtë nga ne, pavarësisht se nuk e japin veten e vishen me kostum e kollare. Ne të gjithë kemi nevojë të lexojmë e të rilexojmë një tregim që shkruan për ato, "Pesha e kostumit" më duket se e ka titullin, i cili flet pikërisht se si ato mundohen të fshehin padijen e tyre e diplomat e blera me lekë nëpër universitete, me kostumin e veshur e kollaren e lidhur në qafë. Asnjëherë nuk e ndjej veten poshtë tyre, diplomë vërtet nuk kam, por as fallco nuk mbaj, sepse pavarësisht se askush nuk ta thotë në sy, të jesh i sigurtë se të gjithë tallen e të nxjerrin gjuhën nga pas.

Kryetari kontrollonte me rradhë të gjithë fytyrat e dumdumsave, përpiqej të gjente efektin e fjalëve të tij sepse në të vërtetë mezi kuptonin, e më shumë të keqkuptonin. Nuk kishin edhe faj, pasi vinin nga fshati e akoma aroma e tij nuk ju ishte larguar. Nuk është kollaj të përshtatesh me një mjedis që nuk ka kurrfarë ngjashmërie me fshatin tënd në majë të malit, nuk është e lehtë të mësohesh me kushtet e reja të qytetit e jo më të kryeqytetit ku askush nuk do t'ja dijë për ty e fëmijët e tu, asnjeri.

-Dumdumsat shihen me sy të keq në përgjithësi nga shoferët, e sidomos nga ato të veturave. Miq, ne na kanë halë në sy, nuk na shohin dot në rrugë e kudo, sepse na kanë zili.

Kryetari mendoi që të përmblidhte të gjithë problemet, sepse edhe mbledhjet i bënin të rralla e mezi mblidheshin, sepse helbete duhej punuar dhe ishin nevojtarë të gjithë. -Krenarinë tonë e ngatërrojnë me të qënit të vrazhdë e brutal, përpiqen të na turpërojnë sa herë që ju jepet rasti. Kjo vjen ngaqë ato njerëz e kanë ngrënë qyl gjithë jetën e tyre dhe ne duan të na vështirësojnë jetën, pasi na shohin si rezik real. Ato janë më të rafinuar se ne, dhe e din mirë se nesër fëmijët tanë do jenë të barabartë me të tyret, nuk është e lehtë ta pranosh këtë, apo jo? Nuk është pak, e kanë të vështirë ta pranojnë. Një të drejtë e kanë, sa i takon edukatës, janë më të sofistikuar ato, janë qytetarë, por ky fakt nuk duhet të na pengojë ne.

Kam parë me sytë e mi në oborrin e Administratës së Jermit e nëpër zyrat e saj, me dhjetra dumdum. Më fliste njëri nga ato të administratës, kur shkova të regjistroj shoqatën, sa më habiti e fillova të ndjehem rehat, sepse të them të vërtetën hiç mirë nuk më vinte kur dëgjoja fjalë lartë e poshtë në adresën tonë. Të përbuzur e të përfolur, si të jemi me kolerë na shohin e na trajtojnë. A nuk është kështu? –pyeti kryeari dumdumsat. Sa herë ju kanë porositur t'ju çoni inerte apo materiale të tjera atyre të administratës, sa herë, e shihni që na e kanë nevojën? Nuk na thërrasin për qejf, të jeni të sigurtë.

Rrinë mbi dosje e shkresa pa bërë një punë, me orë të tëra, sepse nuk e kanë haberin nga punët që ju ngarkohen, detyrohen ta mbajnë vendin e punës me njëqind mënyra shpesh herë dhe të turpshme që asnjeri prej nesh nuk do ti bënte? Le të vishen e pispillosen me kollare e kostume se askush nuk jua fishkëllen, të gjithë e din sa ju vlen lëkura. Ju shihni punën,- mblodhi sallën kryetari.

Që të mos zgjatem, desha t'ju them mos më dilni në rrugë me goma të konsumuara e pa asnjë kusht teknik, sepse na nxorrët bojën, dhe e fundit kam informacion të saktë se lekët që fitoni i lini klubeve duke pirë e duke u bërë tapë. Ky nuk është një problem i vogël por për këtë, do të mblidhemi njëherë tjetër e më konkretisht të flasim, me argumenta dhe emra konkretë, e ti japim drejtim sepse edhe ky fenomen ka efekte negative në opinion dhe në nivelin ekonomiko-finaciar të familjeve tona. Besoj u kuptuam- e mbylli kryetari duke i kaluar në sitë të gjithë dumdumsat sa ishin në sallë.

I pari që brofi në këmbë qe ai dhe nxitoi për te dera që të kap orarin, ishalla më ka pritur, -lutej nën zë. Kishte shumë pak shpresë se do e kish pritur, e kishte merak pritjen ajo. Më tekanjoze ishte bërë kohët e fundit. Ndoshta mendonte ta shkëpuste fare marrdhënien. Gabim bëra që ndejta këtu, në këtë mbledhje pa bereqet, -mendoi. Të gjata pa fund kishin qenë ato minuta të mbledhjes, mezi kishte duruar. Bëri të ec por papritmas kryetari e zuri për krahu, dhe pa ja hequr dorën nga krahu e me sytë nga salla u kujtua:

-Për pak harrova, ajo shprehja "kohë dumdumesh" mos u merrakosni se nuk është vetëm për ne, ju thashë se prek dhe të tjerë shumë më të rëndësishëm se ne, është një problem më i madh nga sa duket... *Tetor 2009*

"Nënë Tereza: shenjtorja e tradhëtuar nga kolegët e saj"

Nënë Tereza u tradhëtua nga kolegët e saj fetarë, kur ajo ndau me ta që dyshimet e saj rreth besimit në Zotin, sipas një studimi të ri të kryer nga akademikët e Universitetit të Birmingamit.

Dr. Gëzim Alpion, lektor i Sociologjisë në Universitetin e Birmingamit, dhe një akademik i dalluar në studimet rreth Nënë Terezës, ka në dorë një studim rreth jetës dhe dyshimeve rreth besimit të murgeshës me origjinë shqiptare. Studimi përqendrohet në marrëdhëniet e trazuara të murgeshës me Zotin në 50 vitet e fundit të jetës së saj, mbështetur në shkrimet private të Nënë Terezës, shumica të botuara për herë të parë në vitin 2007.

Dr. Gëzim Alpion

Kërkimi studimor në vazhdimësi i Dr. Alpionit është kërkimi i parë i këtij lloji akademik që shqyrton dyshimet e Nënë Terezës rreth fesë, studim i kryer jo nga këndvështrimi i fetarëve, por as nga këndvështrimi evolucionist ose ateist.

Në këtë studim, Alpioni i referohet letërkëmbimit që ai ka pasur në tre vitet e fundit me Papën Benedikt XVI, në lidhje me mungesësn e besimit të Nënë Terezës.

"Nënë Tereza u tradhëtua nga njerëzit të cilëve ajo ju besonte më shumë", zbulon Dr. Alpion. "Kjo nuk është e vetmja tradhëti që unë adresoj në kërkimin tim. Ajo ishte një prej personaliteteve fetare më të dalluar dhe të kufizuar në gjithë shekullin e njëzetë, edhe ajo u ndihmua në mënyrë të vakët nga kolegët e saj fetare, të cilët u përpoqën më kot ti shpërlajnë trurin me argumente të dobëta, kur ajo ndau me ta mendimin që nuk besonte më në Zotin".

Zbulimet e këtij studimi do të publikohen në një libër të ri të titulluar "Kush e tradhëtoi Nënë Terezën? - Besimi dhe Mosbesimi në Postmodernitet", libër që do të publikohet në vitin 2011.

Në librin e tij të botuar më parë, "Nënë Tereza: Shenjtore apo Njeri i Famshëm?" (Routledge, 2007; gjithashtu i publikuar në Italisht nga Salerno Editrice, 2008), Dr. Alpion vë re ndikimin traumatic që kishte tek Agnes Gonxhe Bojaxhiu (emrin origjinal i Nënë Terezës) vdekja e papritur e babait të saj, kur Nënë Tereza ishte vetëm 9 vjec. Në këtë libër gjithashtu trajtohen përpjekjet e saj për të zëvendësuar babain e saj me një at hyjnor.

Në këtë studim të ri, Alpion gjithashtu identifikon dhe analizon disa prej arsyeve për këmbënguljen e misionares për të heshtur rreth jetës së saj personale dhe vecanërisht përpjekjet e saj të dështuara gjatë gjithë jetës, që të bindë kishën që të shkatërrojë letrat e saj, ditarin dhe rrëfimet e saj të shkruara; materiale në dorë të etërve të saj shpirtërorë.

Kërkimi studimor në vazhdimësi i Dr. Alpionit është kërkimi i parë i këtij lloji akademik që shqyrton dyshimet e Nënë Terezës rreth fesë, studim i kryer jo nga këndvështrimi i fetarëve, por as nga këndvështrimi evolucionist ose ateist.

Në këtë studim, Alpioni i referohet letërkëmbimit që ai ka pasur në tre vitet e fundit me Papën Benedikt XVI, në lidhje me mungesësn e besimit të Nënë Terezës.

Së shpejti, Dr. Alpion do të fillojë të japë leksione në gjithë botën, në të cilat do të përpiqet të tregojë grupeve të interesuara rreth zbulimeve të tij në fushën e psikologjisë së fesë.

"Ky është ndoshta studimi më i vështirë që më është dashur të shkruaj gjatë gjithë jetës", thotë Alpioni, "Kam bërë shumë kërkime shpirti që nga viti 2003, kur fillova të kem interes rreth Nënë Terezës. Leksionet do të shërbejnë si platformë për të diskutuar vlefshmërinë e deklaratave të mia përpara publikimit të librit".

Deklaratë Shtypi e Universitetit të Birmingamit (25 Nëntor 2009)
Përktheu: Afrim Karoshi

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: "rrugaearberit@gmail.com". Tel. 00355 4 22 33 283.
OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

Ing Haki Kola, shpallet "Qytetar Nderi" i komunës së Grekanit të qarkut të Elbasanit me motivacionin: "Për kontributin e shquar në zhvillimin e pyjeve komunale, për komunikimin dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me banorët dhe pushtetin vendor të komunës"

Kriza mjedisore dhe sfidat e së ardhmes

Nga: **HAKI KOLA**

Nga inventarizimet e fundit re zulton që, burimet natyrore, si pyjet e kullotat, zënë mbi 60% të territorit shqiptar dhe janë burim shumë i rëndësishëm jetese për zonat malore. Ky burim pothuajse është i neglizhuar në rolin aktual që luan, në mënyrë informale, te të ardhurat kombëtare. Pak njihen nga shoqëria e akoma më pak reflektohen nga mediat funksionet ekologjike të burimeve natyrore apo përfitimet e shumta mjedisore dhe social-ekonomike që i ofrojnë shoqërisë. Në heshtje është kaluar, si nga media, ashtu edhe nga politika, kriza e rëndë mjedisore që kalon vendi, apo reduktimi i aftësisë së burimeve natyrore për t'i ofruar këto shërbime dhe përfitime për shoqërinë mbi një bazë të qëndrueshme.

Kriza aktuale mjedisore karakterizohet nga shkatërrimi dhe degradimi masiv i pyjeve, kullotave e shtretërve të lumenjve, si dhe nga shtimi i ritmeve të erozionit të tokës. Duket se kjo krizë mjedisore është tregues i vjetrimit të paradigmave tradicionalë. Kjo e bën më se të nevojshëm zëvendësimin e tyre me paradigma të reja, si instrumente për të përballuar sfidat dhe krizën aktuale mjedisore. Në pylltari dhe menaxhimin e burimeve natyrore, ky model i ri përfaqësohet nga paradigma e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Kjo paradigmë nënkupton një ndryshim në mënyrën që pylltarët profesionistë, tradicionalistë, shohin, mendojnë ose veprojnë në lidhje me pyjet, burimet natyrore dhe mjedisin. Kjo kërkon jo vetëm ndryshime në politika e programe, por edhe në qasjet e aftësive të institucioneve dhe të individëve të përfshirë në menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

Pyjet, kullotat dhe mjedisi, me gjithë problemet e tejskajshme që kanë, duket se janë përdorur nga politika, si resto apo dhuratë pajtimi. Kjo ka bërë që institucionet të paguajnë haraç e të ndodhen në pritje se kujt do t'i takojnë më tej. Në fakt, përballë kësaj krize, çdo institucion që merr përsipër menaxhimin e burimeve natyrore duhet jetë relevant dhe efektiv; ai duhet të jetë në gjendje ta bëjë të vetën paradigmën e re të menaxhimit të qëndrueshëm. E kjo e bën të domosdoshëm ripërtëritjen e programeve dhe proceseve, në përputhje me kërkesat dhe sfidat e mbarështrimit të qëndrueshëm.

Kjo nuk mund të realizohet, duke u mohuar malësorëve atë marrëdhënie me vendin e tyre, që e kanë ushtruar në shekuj. Mbarështrimi i qëndrueshëm është sistem që ka si qëllim të plotësojë nevojat e shoqërisë për të mira materiale dhe shërbime, nëpërmjet aplikimit të parimeve ekologjike e sociale, duke adoptuar metoda të kujdesshme e racionale shfrytëzimi, që mundësojnë ripërtëritje dhe zhvillim të burimeve natyrore, pa degradim apo cenim të kapacitetit të burimeve natyrore për të siguruar në vazhdimësi këto shërbime.

Në këtë krizë të thellë, por edhe përballë sfidave të zhvillimit të ardhshëm, do të ishte e arsyeshme që rolin drejtues ta merrnin institucionet arsimore edukative. Në përgjithësi, nga natyra e tij, arsimi pyjor duhet të jetë në gjendje të këshillojë ndryshimet e sjelljes në termat e dijeve, qëndrimeve, vlerave dhe aftësive të kërkuara, për të realizuar mbarështrim të qëndrueshëm. Këto ndryshime të dëshiruara të sjelljes mund të arrihen nëpërmjet arsimit pyjor formal e joformal. Janë tri përqasje që arsimi pyjor shqiptar nuk po u krijon hapësira, e për pasojë, këtë boshllëk po e mbushin donatorët ndërkombëtarë, duke bashkëvepruar me shoqërinë civile dhe komunitetet malore.

Përgjithësisht, si media e shkruar, edhe ajo vizive, dëshmojnë ndjeshmëri të ulët të publikut përballë krizës mjedisore. Drejtuesit e shtetit detyrohen që, për fjalimet publike të përgatisin sfonde të gjelbra artificiale, që i transportojnë me mjete të posaçme që nga Tirana, si për të manipuluar ndjeshmërinë fare të ulët të publikut. Pa atë maskë, sfondi i politikanit modern do të rezultonte pluhur, tym, gërryerje ose beton.

Për shkollat pyjore, avokatia deri më tani mbetet pothuaj një term i panjohur. Avokatia apo roli i edukimit me njohuri për burimet natyrore, ka për qëllim pikërisht ndërgjegjësimin e publikut. Avokatia synon të rrisë interesin dhe vlerësimin e publikut për të njohur e mbështetur politikat, programet dhe strategjitë për menaxhimin e qëndrueshëm, nëpërmjet një plani të përgatitur sistematikisht e të zbatuar në mënyrë agresive. Për të qenë efektiv, programet e avokatisë duhet të përgatiten për t'iu përgjigjur nevojave apo sjelljeve aktuale mjedisore lidhur me mbarështrimin e qëndrueshëm.

Nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve, arsimi pyjor prodhon burimet njerëzore të duhura për mbarështrimin e qëndrueshëm. Aktualisht, njohuritë shkencore bazë përfshijnë vetëm aspektet biofizike e teknike. Gjuha dhe interpretimi janë, në të shumtën e rasteve, të importuara, shpesh të vjetra, dhe bëjnë kontrast me veçoritë apo traditat mesdhetare të vendit. Traditat historike të përdorimit të territorit, nënvlerësohen dhe përjashtohen si pasuri e trashëgimi kombëtare. Po kështu, mbetet akoma tabu historia e të drejtave të përdorimit apo të pronësisë mbi pyllin dhe kullotën. Terminologjia që përdoret është shumë larg termave të jetës së përditshme e të marrëdhënieve të popullatës me natyrën. Është me shumë rëndësi që ata të pranojnë dhe të përfshijnë edhe dimensionet sociale e humane, për të njohur e menaxhuar më mirë marrëdhëniet e shoqërisë me natyrën.

Përqasja e tretë, e cila mbetet jashtë kurrikulave, edhe pasi Shqipëria ka arritur një përvojë rreth 15-vjeçare me pylltarinë sociale, është ndërtimi i kapaciteteve. Nëpërmjet këtij roli, arsimi pyjor prodhon burimet njerëzore të nevojshme për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave. Përmes arsimit formal, pylltarët profesionistë përfitojnë kompetencat bazë (njohuritë, qëndrimet, vlerat dhe aftësitë) që kërkohen për të realizuar qëndrueshmëri. Nëpërmjet arsimit apo edukimit joformal (trajnimeve apo kualifikimeve), kapacitetet ekzistuese të pylltarëve profesionistë mund të rigjallërohen, ashtu si edhe shumë sjellje të trashëguara nga ideologjia e shtetit komunist pronar mund të zëvendësohen. Zhvillimi i kurrikulave dhe ndryshimet e realizuara përbëjnë një strategji, e cila mund të garantojë që arsimi pyjor të realizojë me efektivitet ndërtimin e kapaciteteve lidhur me nevojat për mbarështrim të qëndrueshëm.

Fleksibiliteti dhe zgjerimi i tematikave kërkimore, si për diplomat, ashtu edhe për mikrotezat apo tezat për doktoraturat, e bën të domosdoshme praninë e nënprogrameve që pasqyrojnë lidhjet e pylltarisë me shoqërinë, traditat e mjedisin, apo lidhjet e pylltarisë me zbutjen e varfërisë, zhvillimin e turizmit etj. Pa mohuar fillimet, do të ishte e arsyeshme të kishte përfshirje më të madhe në programet kërkimore të temave për ruajtjen e biodiversitetit, pylltarinë mjedisore, duke përfshirë edhe ndryshimet klimatike apo potencialet në shtimin e rolit të pylltarisë në fiksimin e gazit karbonik, teknikat e rehabilitimit të tokave të abandonuara e të degraduara, e drejta tradicionale për tokën pyjore e kullotën, pylltaria urbane, pylltaria e bazuar te komuniteti, agro-pylltaria e silvo-pastoralizmi, analiza e politikave pyjore dhe ndikimi te degradimi i ekosistemve (p.sh. të Jugut të Shqipërisë), roli dhe organizmi i shërbimit këshillimor etj. Kjo jo vetëm që do mundësonte fillimin e menaxhimit të qëndrueshëm, por do ta bënte shkollën shqiptare akoma më të kërkuar dhe do t'i rriste asaj kredibilitetin.

Inxhinier Haki Kola shpallet "Qytetar Nderi " i Komunës Grekan të Elbasanit

Ing Haki Kola, shpallet "Qytetar Nderi" i komunës së Grekanit të qarkut të Elbasanit. "Për kontributin e shquar në zhvillimin e pyjeve komunale, për komunikimin dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me banorët dhe pushtetin vendor të komunës", është motivacioni i këtij çmimi vendosur nga këshilli komunal.

Ing. Haki Kola është një nga bashkëpunëtorët e gazetës, i cili ka dhënë një kontribut të çmuar në sensibilizimin e njerëzve mbi gjendjen mjedisore në vend. Por kontributin e tij ai e ka dhënë më shumë në terren, në të gjithë vendin, dhe tani së fundi edhe në Kosovë.

Për një përshkrim më të hollësishëm rreth çmimit dhe veprimtarisë së Ing. Haki Kolës, po botojmë shkrimin e ardhur në redaksi nga njëri prej bashkëpunëtorëve të tij në komunën e Grekanit.

Nga: **Inxh. ISUF SALLA**

Rreth dhjetë vjet më pare në Komunën e Grekant (Elbasan) erdhi inxh. Haki Kola me disa specialistë të tjerë të Projektit Shqiptar të Pyjeve. Ai foli për Projektin dhe mbështetjen që do të jepej për të rimëkëmbur pyjet e kësaj komune.

Kodrat, lugina poshtë, ishin zhveshur nga prerjet e filluara më 1992 e deri më 1997. Pyjet më terpër u prenë nga ata që vinin që nga Kuçova e Lushnja se sa nga banorët vendas. Pas disa takimesh në komunë filloi mbështetja e Projektit të Pyjeve. U planifikuan e zbatuan disa punime përmirësuese, por kryesorja, që u vendos nga vetë fshtarët, ishte ndalimi i kullotjes dhe rrethimi i zonës që do të ripërtërihej. Natyra i ka ofruar kësaj zone kushte të mira ekologjike, Projekti i Pyjeve ofroi investime modeste, banorët vendas shprehën gatishmërinë për të zbatuar të gjitha rregullat teknike dhe ashtu vepruan. Rezultati: Sot Grekani ka një pyll dushku (rreth 800 ha sipërfaqe) në gjendje mjaft të mirë. Jo vetëm mbulimi i sipërfaqes me dushqe, por edhe trajtimi e orientimi për të ardhmen është faza tjetër (më e rendësishme) për këto pyje. Sigurisht, sivikultorët duhet të thonë falën e tyre.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QARKU ELBASAN
KËSHILLI I KOMUNËS GREKAN

Çertifikatë

PËR DHËNIEN E TITULLIT "QYTETAR NDERI" I KOMUNËS GREKAN
INXHINIERIT HAKI KOLA

VENDOSI:

"PËR KONTRIBUTIN E SHQUAR NË ZHVILLIMIN E PYJEVE KOMUNALE;
PËR KOMUNIKIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E SHKËLQYER ME BANORËT DHE PUSHTETIN VENDOR TË KOMUNËS "

SEKRETARI — KRYETARI

Në disa sipërfaqe prove janë bërë trajtime eksperimentale, me mbështeje nga SNV e SIDA-as. Në këto sipërfaqe prove, sipas një metodike të përgatitur nga inxhinirt e njohur Haki Kola e Janaq Male, janë zbatuar katër tipe të ndryshme rrallimi. Rezultatet e eksperimenteve janë prezantuar dhe po ndiqen në vijimësi.

Pylli po rritet e zhvillohet; po parashkruhet e ardhmja e tij, për t'u mbarështuar sa më mirë për plotësimin e kërkesave mjedisore e turistike, në plotësim të nevojave të banorëve për lendë druri. Menduam se ishte i nevojshëm ky përshkrim i shkurtër, pas njoftimit që inxhinieri i pyjeve Haki Kola është nderuar nga pushteti vendor i komunës me titullin "Qytetar Nderi", pasi kështu del më qartë edhe kontributi i këtij inxhinieri të ditur, të apasionuar e të papërtuar, këtij njeriu të lidhur me pyjet, që njeh mirë pyjet kudo në Shqipëri dhe kontribuon për ecurinë e kësaj pasurie me vlera kombëtare. Suksesi është i dukshëm e i prekshëm për këdo që ka rastin të viziotojë këto dushkaja.

Nëse do të urohej për këtë punë apo do t'i vihej një emër i përveçëm, ai do të jetë "inxh. Haki Kola". E themi këtë, pasi ai ideoi e zbatoi jo vetëm një mendim bashkëkohor teknik, por gjeti edhe rrugë të veçanta komunikimi e bashkëpunimi të shkëlqyer me banorët vendas. Ai arrti të ringjallë tek ata ndjenjën e dashurisë për pyllin, shpresën se ato pyje do të ripërtërihen vetëm në saje të kujdesit të tyre. Kështu ka ndodhur. Kemi tashmë të ashtuquajturë "mrekulli të gjelbër në Grekan". Ndoshta këtu qëndron edhe kyçi i suksesit. Urime nga zemra inxh. Hakiut e të gjithë atyre me të cilët ai bashkëpunon.

Ndoshta tituj të tillë nderi do të bëhen të mundur edhe për kolegët e tij, kudo në shumë komuna e bashki të vendit, pasi ka mjaft të tillë, që punojnë e kontribuojnë në shtimin e përmirësimin e sipërfaqeve pyjore, për zhvillimin e këtij sektori sipas kërkesave bashkëkohore.

** Monitorues i eksperimenteve në pyjet e Grekanit*

Intervistë me kryetarin
e komunës, z. Isuf Curri

Rruga Arbërit nr. 43

intervistë

Komuna Fushë-Bulqizë

në rrugën e duhur për të mirën e komunitetit

Nga: **YMER KETA**

Komuna e Fushë Bulqizës shtrihet në lindje të qytetit të Bulqizës, në një distancë prej 10 km. Ka një sipërfaqe të përgjithshme 28 km katrorë dhe është e ndarë në 4 fshatra: Fushë, Dushaj, Koçaj dhe Dragu. Dendësia e popullsisë është 12 banorë për m^2. Komuna ka 708 ha tokë të shpërndarë në fshatrat e sipërm.

Kjo komunë njihet si vendbanim që në mesjetë. Kjo trevë është e banuar qysh në periudhën e Principatës së Arbrit. Për shkak të pozicionit gjeografik, kjo krahinë është e njohur për luftërat e zhvilluara që në kohën e Skënderbeut dhe betejat e panumërta të herëpashershme, për shkak të rrugës që lidh Shqipërinë me Dibrën e Madhe. ushtritë armike kanë lëvizur vazhdimisht në këtë rrugë, prandaj dhe vendbanimet e para që datojnë vonë dhe kanë qenë vendosur kryesisht në skaje të komunës si në Dushaj, në Kokërdhak (Koçaj) etj.

Në kohën e principatës së Arbrit, në skajin lindor (sot Ura e Qytetit) ka qenë vendosur një garnizon ushtarak nga pushtuesit që ruante karvanet nga grabitjet. Garnizoni vendosej një pikë strategjike me emërtimin "Kalaja e Volosit". Fiset e para u vendosën në Dushaj Kokërdhak (Koçaj), fshatra të sotëm me emërtime të ndryshme në atë kohë që u përshtateshin toponimeve ilire. Në këtë trevë ekzistojnë shumë vende ilire dhe sidomos dhe ato të periudhës së Skënderbeut. Ato sot vizitohen nga shumë të huaj dhe vendas. Kjo krahinë ka një shtrirje në luginën e Bulqizës.

Në një intervistë të marrë nga Kryetari i kësaj komune Isuf Curri, mësuam prej tij se nga eksperienca e fituar gjatë kësaj dekade, kjo komunë po kalon fazën e tranzicionit dhe po hyn në një zhvillim të qëndrueshëm.

- Të ndërgjegjësuar në këtë realitet të ri dhe në harmoni me studimin, zbërthimin dhe adaptimin në kushtet e komunës të Strategjisë Rajonale të zhvillimit për Qarkun e Dibrës, unë mendoj se është moment i natyrshëm, favorizues dhe i përshtatshëm për të ndërmarrë iniciativën e hartimit të Planit të Zhvillimit Lokal të kësaj komune.

- Plani i zhvillimit lokal do të krijojë një hapësirë të re zhvillimi për komunën tonë. ne kemi ambicien që duke kuptuar objektivat strategjike të fushave prioritare të zhvillimit, banorët e Fushë-Bulqizës në një të ardhme të afërt do të kenë një mirëqenie me të lartë dhe do të jetojnë në një ambient me shpresëdhënës për të rinjtë dhe të vegjlit e tyre.

- Por më duhet të pranoj se organizimi dhe realizimi i një procesi të tillë, me pjesëmarrëje kaq masive e cilësore njëherësh nuk mund të kryhej prej nesh pa mbështetjen e Këshillit të Komunës, administratës dhe komunitetit. Të gjitha këto përpjekje janë pasqyruar në këtë plan bashkëkohor me vizion që do t'i shërbejë këtij komuniteti në të ardhmen.

Cili është zhvillimi aktual ekonomik?

Në këtë zhvillim përfshihen disa drejtime. Nxitja dhe përkrahja e bizneseve është përmendur edhe në planin e zhvillimit lokal.

Pavarësisht nga të gjitha këto mundësi për zhvillim, në qoftë se bëjmë fjalë për burimet natyrore dhe kapitalin social, niveli i ulët i papunësisë i tejkalon avantazhet e këtyre aseteve.

Në vitet në vazhdim komuna synon të rrisë të ardhurat kryesisht nga tatimi i thjeshtuar mbi biznesin e vogël dhe nga disa tarifa shërbimi. Kjo vjen pasi burimet natyrore në këtë komunë janë të pasura e të shumëllojshme, që paraqesin interes të madh kulturor dhe historik. Afrohet një peizazh i bukur malor, me pyje të shumta e kullota masive shkëmbore që i japin variacion në formë e në ngjyrë peizazhi.

Cila është infrastruktura dhe shërbimet në komunitet?

Nga pikëpamja administrative rrjeti rrugor ka dy pronarë: drejtoria e rrjetit rrugor rural dhe komuna. Rrjeti rrugor dhe transporti është një nga instrumentetet për zhvillim dhe duke qenë i tillë në vitet e fundit, kemi bërë shumë investime duke përdorur fondet e buxhetit të komunës. Kemi asfaltuar rrugën nga rruga interurbane, ura e Përkoljeve, qendra e komunës deri në hyrje të fshatit Koçaj. Gjithashtu kemi asfaltuar nga stacioni "Sul Zeneli" deri në fund të Zhiranës, aty ku ndahen linjat për në "Kodër të Danit" dhe në Lagjet Gropë e Lepurakë, ku bëmë të mundshme lidhjen e lagjes "Lepurakë" nga të dy anët me rrugë automobilistike që banorët e kanë me të lehtë për furnizimin me bazë ushqimore bagëtitë, drutë e zjarrit etj.

Të njëjtën gjë kemi bërë dhe në fshatin Dushaj, duke e lidhur me rrugë automobilistike, pothuajse të gjitha lagjet. Këto investime në të ardhmen do t'i zgjerojmë dhe në linja të tjera.

- Cila është gjendja aktuale e ujit të pijshëm?

Furnizimi me ujë të pijshëm i komunitetit, për neve ka qenë dhe është primare, pasi ujisjellësi i "Kaculit" ishte i dëmtuar e banorët ishin pa ujë. Për këtë u bë ndërhyrja nga ana jonë duke furnizuar me ujë të pijshëm të gjithë banorët e fshatit Fushë, e që aktualisht nuk ka asnjë problem. Të njëjtën gjë kemi bërë dhe me ujësjellesësin e fshatit Dushaj e Dragu duke bërë një rikonstruksion të plotë.

- Po me krijimin e mjediseve çlodhëse për komunitetin, a keni ndërmarrë ndonjëhap?

- Përveç mjediseve në qendër të komunës, kemi investuar dhe në lagjen Kome, duke ndërtuar dhe shtruar sheshin tek "Teqja e Madhe" me pllaka e vendosur stola, për qëndrimin e banorëve në raste festash e kohe të lirë.

Po me kanalet vaditëse a keni bërë ndonjë investim?

Edhe për këtë problem janë marrë masa efikase, gjë që ka bërë të mundur, që kanali vaditës nga Draguni në Fushë apo shulla të funksionojë rregullisht. Gjithashtu morëm masa qe dhe uji i "Fushë Hudrës" të funksionojë rregullisht ku banorët e fshatit Dragu të mos kenë probleme.

Cila është fusha prioritare në të ardhmen në komunë?

Ekonomia e komunës sonë është mbështetur në zhvillimin e mëtejshëm të blegtorisë dhe ka ofruar më shumë mundësi dhe kushte më të përshtatshme për fermerët vendas në shtimin e bagëtive dhe prodhimtarisë dhe në të njëjtën kohë ngritjen e një infrastrukture të përshtatshme me nxitjen e bizneseve e për përpunimin dhe tregtimin e këtyre prodhimeve.

Neve kemi synuar e synojmë që për vitet në vazhdim të qeverisjes tonë, nëpërmjet specialistëve të bëhet përmirësimi racor me tendencë ruajtjen e llojit të vendit. Rritja e kujdesit nëpërmjet vaksinimit të përgjithshëm të kafshëve. Gjithashtu kemi në projekt, përveç blegtorisë që të bëjë një studim për rritjen e peshkut troftë dhe, shtimin e prodhimit të mjaltit duke nxitur aktivitetet ekzistuese.

Po për sektorin bujqësor dhe biznesin, çfarë keni menduar?

Tendenca e rritjes së sipërfaqes së mbjellë me frutikulturë dhe farogjerë, klima e favorshme dhe përdorimi i sasive të vogla të pesticideve ka sjellë shtimin e produkteve biologjikisht të pastra. Shtimi i prodhimit të frutikulturës është shoqëruar dhe me ambicien për të përmirësuar infrastrukturën e magazinimit dhe të konservimit të produkteve. Kjo realizohet me shtimin e sipërfaqeve me pemë frutore duke mbjellë të reja si mollë, kumbulla, varietetet e rrushit, qershi të llojeve të vendit, ku fermerët Hasan Gjimi, Shkëlqim Dervishi dhe Sulejman Farruku jo vetëm që kanë mbjellë sipërfaqe të tilla por po marrin dhe prodhim nga këto mini ferma. Kështu që tek neve do të gjejnë mbështetjen e nevojshme dhe të tjerë.

Puna jonë do të jetë dhe bashkëpunimi me biznesin e tregtimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore për të siguruar shitjen e tyre.

Komuna do të mbështesë individët, subjektet vendase apo të huaja të cilat planifikojnë të ngrenë biznese të përpunimit të produkteve blegtorale e bujqësore, rrobaqepësi, të zhvillojnë industrinë e përpunimit të bimëve medicinave, aromatike dhe atyre industriale duke përdorur si krahë pune burimet njerëzore në komunë, si dhe mbështetjen e ndojnë iniciativë që synon shfrytëzimin e ujërave sipërfaqësore të rrjedhshme të komunës për prodhimin e energjisë elektrike, si në përroin e Balgajit, të përroit të thatë apo të të përroit të Dushajve. Gjithashtu kemi menduar dhe po përgatisim si vend turistik tek "Pishat përbri rrugës nacionale".

Cilat janë prioritetet më kryesore në të ardhmen?

Ndër prioritetet kryesore futet edhe ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve midis fshatrave, se ky staf i palodhur i kësaj komune e që rrugët e mira e funksionale janë qytetërim, janë më pak energji e harxhuar, më pak karburant, më shumë jetëgjatësi automjeti dhe personi. Gjithashtu në projektet tona gjatë mandati të qeverisjes janë dhe ndërtimi i kanaleve të ujërave të zeza dhe ndërtimi i një pike grumbullimi për mbetjet.

Këto prioritete ku bazohen?

Ky plan është i hedhur në letër dhe është i realizueshëm, pasi mbështet mbi objektiva reale ekzistuese. Ai bazohet dhe mbi opinionet e të gjithë aktorëve potencialë lokalë si dhe modele të suksesshme të propozuar prej tyre. Gjithashtu, në konsideratë janë marrë dhe opinione të specialistëve, objektivat e Mijëvjeçarit dhe Strategjia Kombëtare e zhvillimit dhe qeveria Berisha.

Ky plan është i hedhur në letër dhe është i realizueshëm, pasi mbështet mbi objektiva reale ekzistuese. Ai bazohet dhe mbi opinionet e të gjithë aktorëve potencialë lokalë si dhe modele të suksesshme të propozuar prej tyre. Gjithashtu, në konsideratë janë marrë dhe opinione të specialistëve, objektivat e Mijëvjeçarit dhe Strategjia Kombëtare e zhvillimit dhe qeveria Berisha.

refleksione

Ngjarje e vërtetë... Për lexuesin preferova që ngjarja të mbetet anonime, një ngjarje që ka edhe emrin e tij, që e ka jetuar tek prindërit, tek nëna e tij që e bëri shpirtin "dele" dhe e la "kopenë" për të shkuar tek "qengji" i saj në dheun e huaj...

Një baladë e ditëve tona

Nga: **ABDURAHIM ASHIKU**

Ajo, Fuze Ferruku (Zhuzhi) më 16 nëntor 2009 u nis rrugës së gjatë për në përtejjetë. Më njoftoi sot në orën 5 e 37 minuta djali i saj, Lavdërimi. Është tezja ime...

Është edhe një personazh real i jetës sonë, i asaj që na dhemb dhe na djeg, i asaj që sa e sa vite nuk pushojmë së kërkuari, ***bashkimin familjar me prindërit***, me ata që i duam dhe na duan. Ajo, në të shtatëdhjetat e jetës së saj, e sëmurë, u nis një ditë tetori 2006 nga Dibra për të kaluar legalisht Bllatën e ilegalisht Gjevgjelinë. Tregimin për udhëtimin e përjetova si të dëgjoja një baladë. E përshkrova në një skicë, siç ma tregoi ajo më 22 tetor 2006, atë ditë kur bëra fotografinë e fundit të jetës me të...

Tregimi nuk është vetëm për njeriun tim, është edhe për tuajin...

Takimi...tetor 2006

E gjeta shtrirë në një dhomë të vogël që nga njëra anë komunikonte me ballkonin e nga ana tjetër me hollin e një shtëpie në periferi të Athinës. Kur më pa u ngrit në fillim ndenjur e më pas në këmbë. Mosha, rreth të shtatëdhjetave, sëmundja dhe rruga e gjatë ia kishin tjetërsuar pamjen dikur të qeshur e humorin që në raste dasmash e gëzimesh e shpërndante duke ua ngjitur në buzë e në sy të gjithëve. E pyeta nëse ishte në gjendje që ta vendoste gotën e mbushur plot me ujë në tepe të kresë e t'ia merrte valles, siç ia mori jo më larg por trembëdhjetë muaj më parë në dasmën e stërnipit. Qeshi me zemër, ashtu siç qeshte njëherë e një kohë, kur sëmundja ishte larg e mosha ishte pranë. Drejtoi trupin, ngriti kokën siç e ngrinte kur vente në majë të sajë gotën me ujë dhe bëri përpara. U ul dhe sa ndenjëm në mesditën e së dielës së tretë të tetorit nuk e ktheu kokën nga dhoma e vogël dhe nga krevati që një dorë e kujdesshme bije i kishte dhënë formën e qetësisë ditore.

Shtymë paksa në qoshe pijet, çokollatat, frutat e thatë dhe mbi tavolinë vumë mallin e zemrave. E shfletuam siç shfletojmë fletët e një libri duke lexuar të kaluarën, duke pyetur e marrë përgjigje për njerëzit atje dhe këtu, herë duke u ngushur e ngrysur në fytyrë për ata që ikën e herë duke qeshur e u gëzuar për ata që janë e ecin në kohë e hapësirë. Thashë "në hapësirë" sepse nuk ka njeri që nuk e ka përcjellë një pjesë të shpirtit të tij njerëzor larg në dhe të huaj, në Evropë e Amerikë, në Azi e në Australi.

Edhe atë, pikërisht ky, "shpirti i saj i shpërndarë" e kishte marrë me vete dhe si në përrallat e baladat e kishte përcjellë "nëntë male kaptuar".

Naimi, në "Bagëti e bujqësia" e bëri shpirtin e tij "qengj" për t'u kthyer në malet, fushat, pyjet e bregoret... Nuk e ndalën as "njëzet apo tridhjetë vetë". Ishte shpirti i Naimit poet, Naimit shqiptar, Naimit atdhetar. Por Naimi, dhe të tjerë që prashitën kopshtin e poezisë, nuk kam lexuar apo dëgjuar që të marrin e venë në vargje shpirtin e një nëne, të shumë nënave që mbetur "kërcure" mes mureve e nën trarët që kërkëllijnë nga dhembët e brejtësve lëkunden sa herë frynë veriu i ftohtë.

Me Fuze Ferruku (Zhuzhi)

Në Korçë kam dëgjuar që ka një lëndinë që quhet "Lëndina e lotëve".

Një zë me iso të drithëron qenien kur ve në pentagram vargun " Mora rrugën për Janinë...".

Një zë mbi fyellin e bariut të copëton shpirtin kur mbi të derdh fjalët "Moj Fusha e Korabit, o e mjera unë..."

... Ajo, dy herë, siç thotë, "u shtri në tabut" e të dy herët doli. Nuk mund të rrinte, nuk kishte se si të rrinte. Tre djem dhe dy vajza që dolën nga barku e u rrjedh gjaku i saj damarëve, ishin larg, shumë larg, "Nëntë male kaptuar". Asnjërin prej tyre nuk e kishte pranë që t'i mbyllte qepallat e t'i hidhte mbi arkivol një dorë dheu. Njeri djalë, i mesmi, i kishte lënë në shtëpi të shoqen dhe fëmijët, nipër e mbesa që ia mbushnin paksa shpirtin. Ia mbushnin por shpirti i saj ishte i madh shumë, shumë. Donte të kishte në gjoksin e nënës edhe djemtë, vajzat, nuset, nipërit dhe mbesat larg, shumë larg. Kush është nënë, kush është prind, vetëm ata e njohin dhe e përjetojnë një ndarje të tillë, atë dashuri etjepashuar.

... Provoi trokitjet në derën e hekurt të ambasadës. Nuk ia hapën. Tre herë trokiti. Pagoi edhe paratë një më një. I kishin bërë garanci djemtë dhe vajzat, me të tëra dokumentet që duheshin, me firma e vula origjinale. Paratë ia kishin pranuar, garancitë jo. Për diplomatët një shtatëdhjetëvjeçare ishte person i padëshiruar, një person i "rrezikshëm". Për diplomatët, ashtu si edhe për ligjvënësit të pranueshëm në vathën e madhe që kishin sajuar ishin vetëm fëmijët, edhe ata me "pranga në duar", pranga që hapen vetëm në raste festash. Prindërit me një "këmbë në varr" ishin dhe janë të padëshirueshëm. Për ta nuk ka as viza turistike, as bashkim familjar. Edhe në projektligjin e ri që mori hapësirë mediatike dy javë të shkuara për prindër të moshuar, për baballarë e nëna, për gjyshe e gjyshër nuk bëhet fjalë. Ata janë të palakueshëm. Edhe vendi ku jetojmë është dhe do të jetë i fundit në botën demokratike, moderne e të qytetëruar që ndoshta një ditë do ta lakojë këtë ndarje për së gjalli...

... Ndodhi ajo, Ajo që as Naimi e as ndonjë poet tjetër i kohës nuk e ka vënë në vargun e jetës, as në varg e as në muzikë. Dhe nuk e ka kënduar kush....

Ngjarja...

... Një nënë del nga tabuti, siç doli Konstandini nga varri për të mbajt besën e dhënë. Del dhe kërkon e gjen një taksi. Taksixhiu qëlloi të ishte i njohur, nga ata njerëz që besa e vendit por edhe frika e thyerjes në besë formojnë një reaksion të kthyeshëm jetësor. Kur u ul në taksi pa që nuk ishte vetëm. Ishin edhe dy gra të tjera, pak më të reja në moshë, më të shëndetshme por të paafta për të punuar atje ku punojnë të gjitha gratë ikanake. Edhe ata shkonin tek djemtë e vajzat të ngujuar në dheun e huaj...

...Kur u nisën i futën në damarë një qetësues, një ilaç që forconte zemrën dhe vinte në harresë udhët. Nga udhëtimi mban mend vetëm çastin kur e zbritën nga taksia dhe e ngjitën në një makinë, nga ato makina që kanë dy diferencialë, goma me llokma të mëdha të afta që të ecin rrugë pa rrugë. Mban mend edhe momentet kur koka i takonte në tavanin e makinës maloreve duke i hapur një plagë që tashmë ka zënë dregëz. Në vete do të vinte kur makina do të zbriste në fushore, do të ndalonte e përpara i doli djali i madh...

Aty ishte ndarë me dy gratë dhe me taksixhiun e ri...

Me djalin në timon kishte marrë rrugën natën drejt Athinës...

...Kaq mbante mend. Hollësitë i dinte i biri, ikanaku që katërmbëdhjetë vjeç. Në fillim në Fierzë, pastaj në Koman e së fundi në Banjë, tuneleve të gjerë e të thellë të hidrocentraleve. Më vonë, kur ranë klonet e u hapën kufijtë, marshues maleve, në shi, dëborë e diell përvëlues derisa një ditë do të merrte kartën e "lirisë" e pas do ta ndiqte, në të njëjtat rrugë, gruaja e fëmijët, dy vëllezër e dy motra. Ai i kishte bërë pazaret, kishte ngrirë shpirtërisht, dy ditë e dy net, në rrugë, në pritje të nënës. Oh, ç'merak e kishte kapluar, ku i shkonte dhe nuk i shkonte mendja, çfarë skenash i shkonin ndërmend...

Naimi e bëri shpirtin e tij "qengj" dhe e la kopenë...

Nënat, të mirat, të dhimbshmet dhe të pagjumet nëna, e revizionuan Naimin. Ata e kanë shndërruar shpirtin e tyre në "dele" dhe japin zë:

" Kur dëgjon zërin e djalit,
qysh e lë delja kopenë ?
Blegërin dy a tri herë
dhe ikën e merr dhenë...
Dhe n'ia prefshin rrugën,
male, njëzet a tridhjetë...
Ajo fluturon e s'trembet,
hidhet në mes si shigjetë..."

* * *

Shënim – tetor 2006

Ngjarja është e vërtetë. Ka emër dhe adresë, ka itinerar udhëtimi. Nëna, midis dashurisë së djemve e vajzave, të nipërve dhe mbesave e ndjen veten shpirtërisht të shëruar. Ka bërë disa analiza privatisht, pret të marrë përgjigje, pret edhe t'i nënshtrohet një operacioni kirurgjikal. Të gjitha me shpenzimet e fëmijëve...

... Nuk i vura emër. Për lexuesin preferova që ngjarja të mbetet anonime, një ngjarje që ka edhe emrin e tij, që e ka jetuar tek prindërit, tek nëna e tij që e bëri shpirtin "dele" dhe e la "kopenë" për të shkuar tek "qengji" i saj në dheun e huaj...

Kohët ndryshojnë, dashuria mbetet e njëjtë...

Athinë, tetor 2006 - nëntor 2009

... Provoi trokitjet në derën e hekurt të ambasadës. Nuk ia hapën. Tre herë trokiti. Pagoi edhe paratë një më një. I kishin bërë garanci djemtë dhe vajzat, me të tëra dokumentet që duheshin, me firma e vula origjinale. Paratë ia kishin pranuar, garancitë jo. Për diplomatët një shtatëdhjetëvjeçare ishte person i padëshiruar, një person i "rrezikshëm". Për diplomatët, ashtu si edhe për ligjvënësit të pranueshëm në vathën e madhe që kishin sajuar ishin vetëm fëmijët, edhe ata me "pranga në duar", pranga që hapen vetëm në raste festash. Prindërit me një "këmbë në varr" ishin dhe janë të padëshirueshëm. Për ta nuk ka as viza turistike, as bashkim familjar. Edhe në projektligjin e ri që mori hapësirë mediatike dy javë të shkuara për prindër të moshuar, për baballarë e nëna, për gjyshe e gjyshër nuk bëhet fjalë. Ata janë të palakueshëm. Edhe vendi ku jetojmë është dhe do të jetë i fundit në botën demokratike, moderne e të qytetëruar që ndoshta një ditë do ta lakojë këtë ndarje për së gjalli...

... Ndodhi ajo, Ajo që as Naimi e as ndonjë poet tjetër i kohës nuk e ka vënë në vargun e jetës, as në varg e as në muzikë. Dhe nuk e ka kënduar kush....

Rruga Arbërit nr. 43

botime

AGRON TUFA SJELL KATËR LIBRA PËR BIBLIOTEKAT E LEXUESVE

Në edicionin e 12 të panairit të Librit "Tirana 2009", shkrimtari Agron Tufa vjen me katër botime të reja: romanet "Mërkuna e zezë" dhe "Tenxherja" të botuara nga Shtëpia Botuese "Toena" si dhe librat "Thembra e Akcilit" dhe përkthimin e novelës "Pullaliu" të Tolstoit botuar nga Shtëpia Botuese "Zambaku"

AGRON TUFA, mes fantazisë dhe kujtimeve

Nga: **ALMA MILE**

Krijime të imagjinatës, por edhe kujtime të fshehura, që kanë lënë shenjë. Në edicionin e 12 të panairit të Librit "Tirana 2009", shkrimtari Agron Tufa vjen me dy romane të rinj. Bëhet fjalë për romanet "Mërkuna e zezë" dhe "Tenxherja", të cilat u prezantuan dje në stendën e shtëpisë botuese "Toena". I pari një trill fantazor, i dyti një gërshetim mes shungullimave të së shkuarës dhe krijimit.Për shkrimtarin, të dy janë romane të rëndësishëm.

Për "Mërkunën e zezë", Fuga thotë se është i vështirë për t'u zbërthyer nga lexuesi. Ai të çon në një fshat malor, në Korab dhe të fut në psikën, në traditat dhe jetën e banorëve të asaj zone. "Te "Mërkuna e Zezë", Agron Tufa ikën nga simbolika e ndërtuar me lëndë empirike realiste dhe na tërheq bukur, thjesht, ëmbël, në një rrëfim ku përzihen ngjarje, ndodhi, peizazhe realiste, me përfytyrime të praktikave mitike, në një botë ku misteri dramatik përzihet me seksin, jeta dimërore e fshatit malor zhytet në një mjegull të paparë marrëdhëniesh magjie, personazhet bartin një peshë kuptimore dhe një karakterizim psikologjik, që i vendos ata nën një tension dramatik të lëvizshëm", shprehet filozofi Artan Fuga. Për studiuesin Mark Marku, ai është një nga librat më të mirë të kohëve të fundit. "E kam lexuar brenda një nate dhe ndjeva të më kthejë atë shijen e mirë të të lexuarit", thotë Marku, për të cilin librat e Agron Tufës po e fusin letërsinë shqipe me të vërtetë në hullinë e letërsisë moderne. Ai e vlerësoi Tufën si një nga romancierët më të mirë shqiptarë, i cili guxon, rrezikon, por jo deri në atë pikë sa të rrezikojë letërsinë, për hir të eksperimentit. "Gjithë materia lëndore e librit është bërë shtëllunga-shtëllunga dhe është vendosur për t'u tjerrur në tri furka: furka e parë është ajo e natyrës që end indiferente flokët e borës, furka e dytë është ajo e magjisë, endur nga Shartimja dhe Nafaka dhe furka e tretë është ajo e autorit që thur e end tekstin letrar. Ka dhe një tjetër më të madhe, që nënkuptohet, ajo e Zotit, i cili në të madh të Vet, end vetë fijet e jetës së personazheve. Fijet e këtyre furkave tiliksen e kokolepsen me njëra-tjetrën, këputen, bëhen nyje të pazgjidhshme", thotë Balil Gjini. Një tjetër vepër e autorit është "Tenxherja", një vepër me një titull disi kulinar, që të çon në të kaluarën, në kohën e diktaturës. "Është një sagë familjare, që lidhet me një të shkuar të familjes sime, me një 18-vjeçar i cili dënohet. Dhe tregohet i gjithë ai proces i gjatë raskapitës, ku ishte vendosur dënimi me çdo kusht i këtij të riu", tregon Agron Tufa. Ai thotë se libri është një krijim dhe jo një autobiografi, kështu që nuk mund të shfrytëzohet si një libër historik. Megjithatë ai nuk e mohon se në të ka edhe shumë të vërteta, situata reale, njerëz realë, madje edhe emra. Pasi ndau disa mendime e përshtypje me miq e të ftuar në promovimin e librit, shkrimtari Agron Tufa firmosi autografë për lexuesit. Tufa është autor i veprave "Aty te portat Skee", poezi, "Dueli", "Rrethinat e Atlantidës", "Fabula Rasa", "Janusi qindfytyrësh", "La Prueba della tierra", "Avangardë engjëjsh", "Fryma mbi ujëra", "Dibra me sytë e të huajve", "Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX", "Thembra e Akilit", etj

(Marrë nga gazeta "Panorama")

"Tenxherja" është një sagë familjare, që lidhet me një të shkuar të familjes sime, me një 18-vjeçar i cili dënohet. Dhe tregohet i gjithë ai proces i gjatë raskapitës, ku ishte vendosur dënimi me çdo kusht i këtij të riu", tregon Tufa.



botime

Emërtimi i librit "Marsi i vrarë", një metaforë, që zgjon mendimin e lexuesit. Të rrëmben filozofia e personazhit në faqen e parë: "O gugashët e mi, unë dua të jem ju dhe ju të jeni unë".

LUTFI HANKU BOTON LIBRIN "MARSI I VRARË"

E vërteta e vrasjes së Baba Faja Martaneshit

Nga: **ZEJNEL SULA**

Shkrimtari i mirënjohur Lutfi Hanku, autor i një sërë botimesh, këtë radhë i vjen lexuesit me veprën "Marsi i vrarë", që rrezaton dritë nga shpirti i shenjtë i Baba Faje Martaneshit. Unë dhe autori e kemi adhuruar qysh në fëmijërinë tonë.

Bëmat e heroit të veprës zbulojnë patriotin liridashës e nacionalistin me ide humane në shërbim të kombit e të Atdheut. Në 18 pjesët e veprës autori ka vënë thënie origjinale të personazhit kryesor, që shërbejnë si leitmotive. Këto përbëjnë dhe boshtin jetësor të ideve e ngjarjeve.

Emërtimi i librit "Marsi i vrarë", një metaforë, që zgjon mendimin e lexuesit. Të rrëmben filozofia e personazhit në faqen e parë: "O gugashët e mi, unë dua të jem ju dhe ju të jeni unë". Pastaj një prelud, si një sintezë e pavdekësisë. Sa hapet dera e "odës shqiptare" lexohet historia me bukurinë e fjalës dhe të armëve të varura në mur, që prisnin krahët e burrave.

Lutfi Hanku ndjeu kënaqësi të pazakontë, kur rendi me pendë në dorë nëpër vitet e Faje Xhanit. Ai gjeti njerëz të mirë që e ushqyen me material, të cilin e derdhi me dashuri e nikoqirllëk në shtrat origjinal, sa duket si roman, ku janë shkrirë bukur pasuria jetësore me artin shprehës. Është shkruar me sens edukativ mjedisi i Teqesë së Elbasanit, në të cilën personazhi rritet e formohet nga Baba Haçi dhe profesorë e studentë të Normales. Prej tyre zgjuarësia e Fajes "vidhte" kulturë e dije. Formimi edhe me filozofi mistike e veshi dervish dhe më vonë Baba bektashian në teqenë e Martaneshit. Si human e ndërgjegjësoi vetësinë drejt triumfit të së mirës ndaj të keqes. Këtë sens e gjejmë në vepër te personazhet që këpusin hallka negative në shoqëri dhe i zëvendësojnë me dashurinë, urtësinë, mirësinë si pasuri shpirtërore. Autori i materializon këto vlera përmes fjalës bindëse dhe ditarit të personazhit, i cili reflekton botën volitive e cilësitë e karakterit.

Baba Faja gëzonte një autoritet e pushtet shpirtëror në të gjithë shqiptarët, pa dallim feje, krahine e ideje. Autori nuk e ka fshehur këtë peshë, por i ka dhënë personazhit dritë, që ngjallte shpresë e besim përmes fuqisë me thelb filozofik bektashian.

Figura e Baba Fajes zbulohet e rritet që kur angazhohet në luftën kundër pushtuesve italo-gjermanë. Ai arrin të krijojë çetën partizane dhe batalionin e Martaneshit. Veprimtaritë civile dhe ushtarake pasqyrohen në vepër me realizëm si në takime me patriotë, luftëtarë, në kuvende e aksione deri me formacione të mëdha pushtuesish, ku spikatën mençuria, guximi, trimëria e drejtësia e një udhëheqësi për të kapërcyer ndërlikimet e luftës. Karakteri i personalitetit të Babait ndriçon në libër si një idhull qiellor e tokësor.

Sa bindës e real ringjallet nga autori në Konferencën e Pezës, në takimet me Mustafa Gjinishin, Haxhi Lleshin, Myslim Pezën; refuzimet e Babait për pushkatimet me urdhër, Operacioni i Dimrit, marrëdhëniet me emisarët anglezë, debatet për reformimet në Kryegjyshatën Botërore, krimi dhe emocionet në varrezat e dëshmorëve të kombit përbëjnë ashtin e librit.



Lutfi Hanku lindi në Zerqan të Dibrës më 4.4.1933 nga një familje e mesme, patriotike me besim bektashian. U rrit jetim. Mësimet e para i mbaroi në vendlindje. U aktivizua si pionier në luftën kundër pushtuesit italo-gjerman. Mbas çlirimit të atdheut vazhdoi studimet në Normale të Elbasanit dhe Uniken në Peshkopi. Më 1948-1952 ndoqi shkollën pedagogjike në Peshkopi dhe e mbaroi në Shkodër.

Punoi me përkushtim si mësues në shkollën 7-vjeçare të qytetit të Bulqizës, Kastriotit, Zerqanit dhe inspektor arsimi. Më 1956-1960 mbaroi Universitetin Shtetëror të Tiranës, fakultetin Histori-Filologji. Nga viti 1960-1992, mësues i gjuhës shqipe në shkollat e mesme të qytetit të Peshkopisë. Ka drejtuar rrethet letrare të shkollave, bibliotekat dhe aktivitetet shkencore kulturore artistike. Është vlerësuar në konkurimet kombëtare për drama, ansamble artistike dhe estrada me medalje nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës.

Që në vitet '60 ka botuar në shtypin monist përshkrime, skica letrare, tregime, monografi të shkurtra historiko-letrare në përmbledhje me shumë autorë dhe në gazeta e revista të sistemit monist dhe pluralist. Në TVSH janë shfaqur tre telefilma për heronjtë e Dibrës. Më 1974 botoi "Nëpër gjurmët e heroit" dhe më 1980 ribotoi "Nazmi Rushiti". Në vitin 2000 "Kaçaku", më 2003 "Drita e shpirtit". Më 2006 romanin "Erdhi Caushi", më 2009 "Marsi i vrarë" (vepër historiko-letrare). Më 1975, anëtar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë.

Dekoruar dy herë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, vlerësuar tri herë me dëshminë "Mirënjohja e kombit", vlerësuar nga Bulqiza "Qytetar Nderi". Ka drejtuar ca kohë gazetën "Dibra".

Koha mbas çlirimit e përballi me probleme më të ndërlikuara. Duke mos qenë më drejtues i një institucioni fetar, ëndërronte dhe krijimin e familjes së tij. Baba Faja e kishte menduar drejt: Familje ka pasur dhe Muhamedi, edhe imamët me radhë. Mos krijimi i familjes nga klerikët bektashinj qe bërë për motive krejt ordinere, ndaj nuk kishte asnjë cënim të udhës së shenjtë. Si duket, në reformim u shfrytëzua situata e krijuar, sa u përdor skenari politik i tragjedisë. Dokumentacioni i shfrytëzuar në vepër fokuson se vrasjet në Kryegjyshatë u fshehën nën vetullat e krimit. Sa mbarova së lexuari veprën "Marsi i vrarë", ndjeva erën e një fruti të pjekur.

Erikson Aga, talenti i portës shqiptare provohet tek Fraiburg

Futbolli është i lidhur me talentin dhe të dhënat fizike dhe jo çdo njeri që ka dëshirë e pasion për t'u bërë futbollist mund t'ia arrijë këtij qëllimi. Parametrat e kërkuara të kombinuara me pasiononin, stërvitjen e kushtet e saj patjetër që premtojnë që të arrihet rezultati i dëshiruar. Një talent i tillë, që ka të dhëna premtuese, si portier i ardhshëm, pse jo edhe i portës shqiptare, është Erikson Aga, i datëlindjes 1991, me një gjatësi trupore 196 cm, nga Grazhdani i Dibrës e banues sot në Tiranë. Eriksoni ka filluar futbollin në moshën 8-vjeçare me ekipin e Laprakës. I dashurar si gjithë fëmijët me lojën e bukur të futbollit dhe i përkrahur e mbështetur nga trajneri i parë i tij, S.Adili, ai do të stërvitej rregullisht me ekipet e moshave në Laprakë, ku që aty tregoi se premtonte për të ardhmen si një portier që nesër do t'i shërbente portës shqiptare. Eriksoni filloi studimet në shkollën e mjeshtërisë sportive "Loro Boroçi", ku tashmë është në vitin e fundit. Aktualisht aktivizohet me ekipin "Shkëndija", në kampionatin e të rinjve të Shqipërisë. Për rritjen e tij si futbollist e si portier ai ka marrë mësime e ka zhvilluar stërvitje nën kujdesin e mjeshtrit , legjendës së portës shqiptare, Perlat Musta. Perlati i njeh mirë cilësitë e tij dhe të dhënat që janë një garanci për t'u bërë një portier me vlera për kombëtaren tonë. Eriksoni ka tërhequr vëmendjen e shumë specialistëve të futbollit, që merren me përgatitjen e ekipeve të moshave. Ai është thirrur edhe në ekipin kombëtar U-19, nën drejtimin e trajnerit Ramadan Shehu, ku ka luajtur dhe ka rënë në sy aftësia e talenti i tij si portier. Në ndeshjen miqësore të ekipit tonë kombëtar U-19 me ekipin e Maqedonisë, ndeshje e cila u zhvillua në Ohër, spikati me pritjet e tij vendimtare, duke u duartrokitur nga sportdashësit e shumtë që ndiqnin takimin në Ohër. Për këtë, një gazetë sportive maqedonase do të theksonte se portieri kuqezi shqiptar ishte futbollisti më i mirë në fushë, teksa priti gjuajtje të pabesueshme dhe tregoi talent, duke bërë mrekullinë në disa raste. Vlen të përmendet se vitin e kaluar, ekipi i Vllaznisë së Shkodrës e afroi në radhët e saj, ku mjeshtri Paulin Ndoja do të dallonte te ky djalosh cilësitë e duhura për një portier të së ardhmes, por burokracitë dhe rregullat e shkollës, nuk e lejuan të vazhdonte tek ky ekip. Aktualisht Eriksoni është duke kryer një provë në Gjermani dhe shpreson se me paraqitjen e bërë gjatë provës një mujore në Fraiburg, i ka bindur dhe shumë shpejt do të jetë lojtar i këtij klubi. Megjithëse i larguar në kërkim të një të ardhmeje më të mirë të tij, ai shpreson që me paraqitjet e përgatitjen të mbetet nën vëzhgimin e vëmendjen e trajnerit të kombëtares së të rinjve për të marrë pjesë në eliminatoret e kampionatit europian që do të zhvillohet në Itali në muajin nëntor të këtij viti. Padyshim, që të tillë element nuk duhet të na largohen. Ndaj është mirë të mendojmë seriozisht qysh tani. Ia vlen të merresh me to pasi nesër krenohet vendi ynë në kampionate botërore.

/ **Sh. Skarra**

Kur kërkonim minerale

Nga: **Vesel HOXHA***

Ishte viti 1981. Sektorin e ri të ekipit gjeologjik për kërkim - zbulimin e mineralit të hekurit pa nikel, siç hyri në fjalorin e asaj kohe ky emërtim, tashmë e kishim ngritur dhe nuk punonim më si dikur me çadra. Sipër mbi fshatin Ploshtan, në vendin e quajtur **Hurdha e Bidanit,** në jug të kodrës së **Rreshkës,** ishte vendosur qendra e ekipit, e përfaqësuar me një ndertesë kryesore me parafabrikate betoni dhe dy baraka të mëdha me dërrasa pishe (menca me guzhinën dhe magazina me furrën e bukës). Vendi ishte deridiku i sheshtë e i mbrojtur nga erërat e frikëshme të asaj zone sidomos në periudhën e dimrit. I ngjante një terrace të vogël jo të vazhdueshme në shpatin perendimor të malit të Sorokolit. Nga ana gjeologjike terraca në fjalë përfaqësonte një ulje shkallore tektonike te formacioneve paleozoike drejt lindjes, drejt fshatit Ploshtan dhe, ndodhej rreth 1,5 km ndën shfaqjen e mineralizuar të hekurit **Gurët e Kodrës,** ku kishim përqëndrimin e punimeve kryesore. Në verilindje te sektorit, rreth 500 m larg tij, nëpërmjet një ujësjellësi të ndërtuar enkas, merrej ujit e burimit të **Gurëve të Dhëlprës** me një debit (prurje) të vogël por të mjaftueshëm për nevojat tona. Uji ishte i një cilësie shumë të lartë, me tregues të analizave kimike më të mira se treguesit e burimeve karstike te Staneve të Preshit ku merret sot nje pjesë e sasisë së ujit që furnizon qytetin e Peshkopisë dhe disa fshatra. Uji buronte në pjesën e poshtëme te Kuarciteve (lloje shkëmbore të forta, përdoren si lendë e parë për prodhimin e qelqit etj.) në vendin me të njejtin emër, duke gjarpëruar nëpër grimcat e kuarciteve dhe kuarcit **(SiO_2)** të shëndritëshme, duke na dhënë një pamje me bukuri të rrallë. Edhe kur nuk e kishim ngritur sektorin, më kishte rastisur shpesh të kaloja pranë këtij burimi, të ndaloja e të pushoja për të shuajtur etjen e për tu kënaqur më këtë xhevahir të natyrës. Në përgjithsi ujët e formimeve rreshpore paleozoike apo të atyre me moshë më të re, eshtë i një cilesie të lartë por me debite të vogla. Me të drejtë fshatarët e kësaj krahine me eksperiencën e tyre nder vite e shekuj kanë identifikuar cilësine e këtyre ujrave. Shumë ujëra në këto formime rreshpore, sidomos kur në sipërfaqen e tyre kemi zhvillim masiv te Lajthisë dhe Dushkut, pamvarësisht debitit te vogël, janë shfrytëzuar ndër vite nga banorët e këtyre zonave jo vetëm për tu pirë por dhe për nevoja të tjera jetike. Ngritja e sektorit ishte bërë për të përballuar volumet në rritje të punimeve të zbulimit, bazuar në projektet perspektive që ishin hartuar e miratuar për zonën mineralmbajtëse. Punonim me të gjitha llojet e punimeve per kërkim - zbulimin e hekurit oksido - silikat në malësinë e **Sorokolit** në disa objekte. Kishim në punë katër sonda **KA-2M 300 Sovjetike** dhe dy sonda **XJ-Kineze**. Që të gjitha makineritë punonin me energji elektrike, të lidhura me gabinën e vendosur posaçërisht për përballimin e fuqive elektrike të instaluara nëpër sonda dhe ne stacionin qendror të pompimit të argjilës nga ku bëhej përpunimi i solucionit të saj dhe shpërndarja nëpër të gjithë instrumentët shpues. Energjia elektrike nga **gabina për tek konsumatorët** transmetohej nëpërmjet disa kabllove tre fazore të trashë që gjarpëronin nëpër bjeshkë mes për mes barit të saj, të cilat për një kalimtar të pa mësuar apo të pa vëmendshëm të trebnin, sikur të vendosje këmbën në ndonjë **zvarranik** (gjarpër, zhapi etj.). Kabllot ishin të një cilësie të mirë, me një diametër mbi 45 mm, me katër mikrokabllo me tela bakri brenda, të prodhuara në **Uzinën e Telave të Bakrit në Shkodër** me veshje solide pvc-je. Ishin tepër praktike dhe kryenin shumë mirë rolin e linjës lëvizëse trefazore në male duke zgjidhur më së miri furnizimin me energji elektrike edhe pse sheshet për kryerjen e shpimeve ndryshonin herë pas here. Këto kabllo pune trefazore i kalonin 1.5 km gjatësi linje totale. Vendlidhjet e pjesëve të tyre ishin tepër të sigurta, të izoluara mirë dhe të maskuara në kuti druri nga të gjitha anët dhe, te ngritura pak nga toka. Sigurimit teknik në punë i kushtohej një rëndësi e madhe, aq më tepër kur bëhej fjalë për rrymën elektrike, e cila nuk të le të gabosh dy herë. Zona ku kryenim punimet e shpimit sherbente dhe si kullotë për vendasit. Tufat me të imta e të trasha që vinin nga fshatrat e Ploshtanit, Vasies, Bushtricës, Matranxhit, Gjegjeve etj. çdo ditë kalonin mes për mes zonës së punimeve. Mundësia për të rënë në kontakt me rrymën elektrike ishte e madhe. Ndaj këtij problemi i kushtohej vëmendja e duhur. Masat për tu mbrojtur nga aksidentet duhen marrë edhe kur rreziku eshtë i vogël. Sherbimin elektrik në ekip e mbulonte i palodhuri dhe talenti Isuf Lela.

* * *

Elektriçisti Isuf Lela që realizonte shërbimin elektrik në ekip, shkëlqente. I shkëlqente edhe puna. Punonte nga mëngjezi deri në pasditën e vonë. Më ishte krijuar përshtypja se ky njeri **nuk e dinte ç'është lodhja**. Punonte shumë e nuk bënte zhurmë e as nuk e rrihte asnjëherë gjoksin. Të vetmen gjë që kishte Isufi, shefave nuk u thoshte asnjëherë jo. Kur e kritikoja për këtë **ves** apo i kërkoja të më shpjegohej pse vepronte kështu, më përgjigjej prerë e me humor: Ec e thuaj jo po deshe shefit, une e kam **provuar një herë të them jo** dhe, ju e dini ç'më gjeti. **Punë dhe heshtje** ishte perkufizimi në pak rrjeshta i këtij mjeshtri të elektricitetit. Isufi nuk ishte inxhinier, por punën e inxhinierit bënte. Nuk mbaj mend që në periudhën e verës, ku realizonim volumin më të madh të punimeve, të hante drekë para orës shtatë të pasdites. Ku nuk e gjeje **Isuf Lelën**. Nga fshati Ploshtan, ku fillonte linja jonë e tensionit të lartë e gjerë te kabina në majat e Sorokolit (Gurët e Kodrës etj.) me gjatësi rreth 3.3 km, gjithçka ishte bërë nga duart e Isufit. Po ashtu nga gabina e ekipit e deri tek sondat, galeria apo stacioni i argjilës, gjithçka elektrike **kishte vulën e punës të Isufit.** Tek futesha ne barakat e sondave më binte menjëherë ne sy rregulli i instalimeve elektrike. Kur ndonjëherë i bëja ndonjë vërejtje të vogel për punën, më shumë për ta ngacmuar, **ai më thoshte me humor**: Për të bërë vërejtje eshtë më lehtë se sa për ti ripauar ato duke mu përgjigjur dhe ai po me humor. Duart e Isufit ishin bërë si **lëkurë pishe**. Kallot në duar ishin kaq të mëdha e të forta sa që ai një pjesë të tyre i **priste me thikë.** Tek e shikoja jo rrallë te kryente këtë veprim ndjeja njëherësh dashuri dhe dhëmbëshuri për të. Në shtëpi shkonte një herë në muaj, jo vetëm pse e kishte larg **(Selishtë)** por edhe pse kishte shumë punë. Kjo për faktin se një pjesë e shpimeve ishin të cekët dhe kishim transporte të shpeshta sondash, për pasojë prania dhe puna e Isufit ishte domosdoshmëri. Kësisoj nuk mund të bëhej puna me akord, që të kishte mundësi të grumbullonte pushime plus. Shpesh shkonte vetë në Bulqizë edhe për furnizime. Do të shkoj vetë ti marrë materialet inxhinier **-më drejtohej mua-** pasi unë i dijë ato që më duhen. Po nuk e kontrollove magazinën vetë ata të përcjellin. Ku duan t'ja din ata. Këtu në male dhe ajo na duhet, të na sjellim materiale tjetër për tjetër dhe hajde pastaj e realizoj detyrat e planit. Ky ishte në pak rrjeshta **Isuf Lela** i Selishtës.

Pamje e Liqenit të Gramës

* * *

Punimet minerare nëntokësore (galeritë) ishin të mekanizuara. Puset dhe kanalet nuk mund të mekanizoheshin për vetë natyrën dhe shpërndarjen e tyre në zona të largëta e të ndryshme. Numri i punëtorëve në tërësi e kalonte shifrën 120, rrallë dhe më shumë, sidomos në periudhën e verës kur na duhej të kryenim punimet sipërfaqësore të kërkimit deri 2-3 orë larg bazës, duke ndjekur e verifikuar në shtrirje zonën xeherore (zonën me mineral). Në shërbim të volumit të madh të punimeve që realizoheshin me shpime dhe me punime të tjera minerare e sipërfaqësore ishin të angazhuar shumë punonjës ndihmës siç emërtoheshin në atë kohë punonjësit që nuk lidheshin direkt me prodhimin ose me frontin e vështirë të punës. Njeri nga ata e më i dalluari ishte elektriçisti që sapo e permendëm më lartë. Vinin pastaj me rradhë guzhinieri, furtari, brigadierët e sondave, zjarmëtarët, motorristët, pompistët, kryesondistët etj.. Rruga e makinës nga fshati Ploshtan për në sektorin e ri të ndërtuar, ishte hapur tashmë, kësisoj të gjitha furnizimet vinin drejtë e në ekip. Vuajtjet e mosardhjes së materialeve në ekip kishin kaluar. Edhe nje **diagaç ushtrie i luftës së parë botërore,** me të cilin bënim transportin e materialeve nga fshati Ploshtan e deri ne sektor, kur rruga e makinës nuk ishte ndertuar akoma, sikur **e kishte parandjerë përfundimin e detyrës** dhe u prish pak para ndërtimit të saj. Kur merrte malorën e Sorokolit për të dërguar ngarkesat që vinin nga Bulqiza, nga fshati Ploshtan për në qendër të ekipit, **pothuaj gjithë krahina** e Kalasë së Dodës e dëgjonte zhurmën e motorrit të tij. Motorri te krijonte përshtypjen se e nxirrte naftën pa e djegur fare, duke lënë pas një shtëllungë të zëzë tymi.

* * *

Më bënte përshtypje tek e manovronte gjithë atë makineri të madhe e të vjetër specialisti Faik Ferati nga Kullasi (Çernjeva). Faiku ishte i vëllai i **Hulë Feratit**, një njeri i mirë që nuk do ta harroj kurrë edhe pse kam shumë vite pa e parë. Që në fillimet e para të punës në Sorokol ai na u gjend pranë. Punonte si traktorist pranë kooperativës apo varej nga SMT-ja e Peshkopisë (sektori Sllovë), këtë nuk e mbaj mend mirë. Rruga e makinës për në sektor mungonte. Do të ndërtohej më vonë kur punimet do të merrnin rezultatet e para e premtuese dhe do të intensifikoheshin. Në atë kohë nuk kishim mundësi pagese. E shumta që mund ti benim dhe që pranonte dhe ai ishte një **çaji mali, apo ndonje metër linear kavo çeliku** nga ato të sondave. Shumë sonda e materiale të rënda janë ngjitur në lartësitë e këtij mali **nga traktori i Hulës**, duke qarkuar rrugë pa rrugë shpatin e Sorokolit. Edhe të vëllanë në punë e pranuam me lehtësi **falë dhe respektit që kishim për të,** ndonëse ai e njihte mirë makinerinë dhe ishte i vetmi që mund ta drejtonte atë mjetë të vjetëruar. Nuk do ta harroj dhe për faktin se na ndihmoj vite e vite me rradhë pa kurrëfarë interesi me traktorin e tij **"të palodhur".** Na ndihmonte ky njeri i thjeshtë e fjalë pak edhe nga deshira e madhe që kishte, që në këtë zonë me tre muaj verë, të shpejtoheshin kerkimet e të hapej drita jeshile për fronte pune për pupullatën e kësaj krahine të njohur në të gjithë shqipërinë për delet rudë dhe shtegëtimin aq të përfolur në periudhen e të **ashtuquajturit socializëm.**

* * *

E mbajtëm shumë vite ne oborrin e Ekspeditës në Peshkopi makinerinë e luftës së parë botërore, diagaçin, duke bërë kurioz të gjithë kalimtarët, deri sa i erdhi rradha për në kombinatin e Elbasanit. **Kjo ishte në vija të përgjithshme gjendja e ekipit tonë gjeologjik në Sorokol atë vit.**

Ishte fund Qershori. Isha ngritur më herët se zakonisht. Guzhinieri **Agim Ferati** ishte ngritur akoma më herët se unë. Kishte ndezur sobën e madhe në guzhinë dhe po merrej me pergatitjen e mengjezit per punëtorët që do të venin në punë në turnin e parë. Tymi i sobës ngjitej pa pengesa ne qiell ç'ka paralajmëronte **një kohë të mirë**, të paktën për atë ditë. Kështu na thoshte Agimi, i cili nuk shquhej vetëm **për guzhinën** por dhe për **parashikimin e motit** me metoda popullore të vrojtuara e të provuara ndër vite e shekuj në këtë krahinë. Po ashtu kishte ndezur edhe **radion me zë të lartë** ku tingujt e muzikës popullore burimore shqiptare, që transmetonte radio Tirana në orët e para të mëngjesit, përhapeshin kudo. E vetmja "zhurmë" që dëgjohej ishte zeri i radios së guzhinier Agimit, i një radioje Kineze, **që kur ndalonte ndonjëherë,** me një të goditur të Agimit vazhdonte të punonte përseri. Gjithmonë e kam dashur dhe shijuar muzikën popullore, në veçanti atë Kosovare, por në atë mëngjez të ftohtë vere nuk e pata mendjen tek muzika. Isha i shqetësuar. Duhej të ngrinim një bazë verore me çadra në Rrafshin e Korabit, larg bazës së ekipit ku ishim stacionuar mbi Ploshtan. Po përgatitja materialet e punes qe do më duheshin atje, deri në vogëlsira si dhe, disa paisje fjetjeje. Që në darkë kisha porositur punëtorë të ekipit që të vinin 3-4 kafshe për të bërë transportin e materialeve në Rrafshe. Me zjarmëtarin **Safat Hoxha** nga fshati Tejas kisha biseduar që të organizonte transportin e materialeve eksplozive dhe të bënte sigurimin e tyre afër postës kufitare të Rrafshit të Korabit. Në afërsi të saj ndodhej **një bunker i mjaftueshëm** për sasinë e materialeve eksplozive që do të na duheshin. Me komandantin dhe kujdestarin e postës verore te Rrafshit të Korabit ishim dakorduar. Ne do të vendosnim vetëm një derë metalike në hyrje, duke e mbajtur çelesin e derës në fjalë zjarmëtari ynë. Rojet e postës do të ruanin depon tonë fushore. Ky ishte një favor e kursim i madh për ne, përndryshe duhej të paguanim katër roje me armë. Këtë e kerkonte rregullorja e sigurimit teknik në punë. **Me të nuk bëhej shaka**. Do te punonim ne ndjekje te disa daljeve e shenjave minerale në shtrirje, kryesisht me kanale e pastrime (pra me punime të lehta, siç i emërtojmë ne gjeologët punimet e kësaj natyre) dhe më pak me puse, qe do te hapnim në një zonë që shtrihej nga **shfaqja polimetalore** e **Burimeve te Izvirit** ne perendim, e deri ne **Qafen e Rosnikut** ne lindje, pranë kufirit me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, tek **Piramida nr. 2**, me nje gjatesi mbi 5 km. Veç shfaqjes në fjalë në këtë rajon ishin takuar edhe shfaqje te tjera të mineralizimeve të **hekurit oksid, hekur - manganit, arsenikut dhe shenja te mineralizimeve te bakrit, arit, zhivës** etj.etj.. Nga mineralet jo metalore veçojmë gëlqerorët e mermerizuar **deri mermere te Shpellasit**. Këto të dhëna tepër interesante si dhe, bazuar edhe në disa njoftime gjurmuesish popullor, në veçanti të zjarmëtarit tonë Safat Hoxha, më shtynin çdo çast ta ngrija këtë bazë fushore verore, edhe pse mundësitë i kishim të vogla. **Nga Bulqiza e largët** ku ishte qendra e Ndërmarrjes**, nuk shikohej me sy të mirë zgjerimi i punimeve ne zonën e Peshkopisë, aq më tepër në Korab, kjo jo vetëm nga mosnjohja e problemeve gjeologjike në tërësi për këtë rajon por, interesat e çastit për kromin dhe planin, bënin punën e vetë. Mendonin se kishin plot telashe në pellgun e Bulqizës dhe kësisoj nuk donin telashe të tjera.** Në bazën e Ploshtanit punët ishin deridiku të stabilizuara dhe, punimet gjeologjike të zbulimit **mund të ndiqeshin nga teknik gjeologu** i ekipit Halit Koka, pa problem, pasi ishte përgjithësisht një punë rutinë dhe e perballueshme, falë dhe eksperiencës që tashmë ai e kishte fituar. Pamvarësisht nga të gjitha këto, shqëtësim mbi shqetësimet kisha në se do ti orientoja drejt punimet, në se do të kisha rezultat, në se do të isha në gjendje ti bëja sakt hartat apo do të kisha nevojë për

në çadër

Isuf Lela, Faik Ferati, Agim Ferati, Safat Hoxha, Halit Koka, Rasim Shehut, Safat Hoxha etj. personazhe reale të kohës, vijnë në shënimet dhe kujtimet e Vesel Hoxhës

rrëzë Malit të Korabit

ndihmë të specializuar në terren, pasi kampionet do analizoheshin ne Tiranë. Ç'mendonin burokratët për mua nuk kishte rëndësi, falë telasheve që më sillnin.

* * *

Teknik gjeologu Halit Koka banonte në fshatin Stredok. Një fshat malor rrëzë maleve të Korabit, në këmbët e bjeshkës së Preshit dhe asaj të Shehut. Sot ky fshat së bashku me fshatin Rade njihen me një emër të përbashkët, Radomirë. U gëzova shumë kur erdhi me punë në ekipin tonë. Në fillim u gëzova per faktin se ai ishte nga krahina e Kalasë së Dodës ku kishim qendrën e ekipit, më vonë do te gëzohesha dhe per sjelljet e tij shembullore dhe aftësinë profesionale. Ai shumë shpejt u njoh me llojet shkëmbore dhe mineralet e zonës si dhe me nje sërë dukurish gjeologjike. Gëzonte respektin e punëtorëve, falë dhe faktit se shumica e punonjësve ishin nga e njejta krahinë dhe kishin njohje e lidhje nga më të ndryshmet mes tyre. Problemet e dokumentimit gjeologjik i njihte në detaje dhe kësisoj nuk i shpëtonte gjë pa e vënë re. Shkurt, për punën që kishte detyrë të kryente, nuk kisha më mëdyshje. Nuk kaluan shumë vite pune dhe ai ishte në gjendje të drejtonte punimet dhe të zbatonte projektin edhe kur unë mungoja në ekip.

Njohja me Halitin nëpërmjet punës e jetesës nëpër male e çadra u thellua shumë. Midis nesh lindi një dashuri e sinqert e vllazërore. Tek shtëpia e tij shkoja shpesh sidomos te shtunave kur nuk kisha mundësi të kthehesha pranë familjes. Shtëpia e Halitit mu bë si shtëpi e dytë, si e shumë e shumë të tjerëve ne këtë krahinë bujare e sedërlie. Prindërit e Halitit më respektonin shumë dhe gëzoheshin kur shkoja. Gjithë Kalaja e Dodës i mbante në gojë për mirë. Ata nuk kishin ndonjë pasuri, por ishin të pasur në shpirt, ishin njerëz të thjeshtë dhe shumë bujar. Muhabeti që benim me to më pëlqente shumë dhe kjo bënte të mos e kuptonim sa ecte ora. Nuk flinim asnjëherë para orës 12 të natës. Shpesh shkoja edhe në muajin e madhnueshëm të Ramazanit. Babai i Halitit kishte punuar për shumë vite guzhinier në Peshkopi duke mos e ndalur asnjëherë agjërimin. E njihnim të gjithë në Peshkopi. Sa herë që shkoja më thoshte me humor: Revaninë do ta gatuaj unë, të tjerat le ti bëjnë vetë. Ma bënte këtë perjashtim si shpreshje të respektit, pasi unë e pëlqeja embëlsirën dhe në veçanti revaninë. Mbaj mend një thënie të çmuar të cilën nuk kujtoj nga e kishte marrë, por mbaj mend sentencën e saj: Biseda me dijetarë të vertetë, eshtë më e embël se mjalti, pale më, krahasuar me revaninë time. Qeshi pak dhe vazhdojnuk kam folur me shifra siç flasin nga krahina juaj dhe Luznia, thjeshtë desha të të them diçka me vlerë që kisha dëgjuar. Ne nuk jemi dijetarë, jemi larg shumë larg, por luftojmë të bëhemi. Nga Hafiz Pajazit Tafa, në Peshkopi, kisha mësuar se dituria eshtë thesar dhe çelësi i saj eshte te pyetësh dhe të mësosh. Kjo është edhe më me vlerë -e mbylli këtë temë babai i Halitit, Veliu, zoti e pastë shpërblyer me xhenet. Në Kala edhe në kohën e monizmit mbahej ramazan. Sigurisht jo aq hapur por, vëreja se nuk ngacmohej shumë në këtë pikë kjo zonë. Kur ndërruan jetë prindërit e Halitit bëra si bëra dhe shkova ne fshatin e tij të lindjes për ta ngushlluar atë dhe vëllezrit e tij të dashur Valën dhe Emërlinë. Nuk mund të rrija pa shkuar, edhe pse nuk punoja më atje...! Edhe sot e kësaj dite kur i takoj në të rrallë, kam një ndjesi dhe mall të veçantë për të gjithë djemtë e Veli Kokës! Po ashtu nuk do ta harroj kurrë ate qe me thoshte shpesh xha Veliu se "Kjo bote eshte vend per te punuar, pagesa behet ne ahiret".

* * *

Fakt është se realizimi i rezervave gjeologjike ishte i lidhur me ecurinë e punimeve të shpimit, të cilat për hirë të vertetës nuk patën ecur me ritmet e dëshiruara. Realizimi i shpimeve ne shtresat shkëmbore te Sorokolit ishte i veshtirë, kërkonte teknologji të veçantë e të avancuar dhe sasira të mëdha argjile. Kësisoj kostua e punimeve dhe telashet organizative për realizimin e metrazhit ishin te mëdha. Ndonëse dhe ne kishim pjesën e përgjegjësisë tonë në këtë mosrealizim, por në fund të fundit neve **na kerkohej minerali**, **sasia dhe cilësia e tij**, për sonda kishte **inxhinier sondash**, edhe pse nuk kishin dëshirë të punonin në Korab e larg familjes, duke na i lënë neve gjeologëve edhe këto probleme. Problemet e planit në përgjithsi trajtoheshin si telashe e të gjithëve por në veçanti ishin **vetëm e gjeologëve.** Mendoj se gjeologët e zonave të largëta në shumicën e rasteve **jane penguar në punët e tyre të profesionit** duke u marrë **shumë me probleme organizative** dhe ecurinë e shpimeve apo punimeve të tjera gjeologo-zbuluese. **Na binin në qafë** me pa të drejtë por, të mos harrojmë se ishte kohë tjetër dhe partia të urdhëronte e planet duheshin realizuar. Kerkesa e llogarisë për realizimin e volumeve fizike dhe rezervave minerale **ishte në shkallë të lartë**. **Shteti dhe partia paralel** të kërkonin llogari. Unë duhej të përgjigjesha për gjithçka ndodhte ne sektor. Në këtë këndvështrim largimi im nga ekipi **nuk shihej mirë**. Megjithatë, në këto rrethana mendoja se **do të ishte më me dobi** puna që do të ndërmerrja, zgjerimi i perspektivës së mineralmbajtjes. Sondat dhe sektorin, aty i kisha, por verën se gjeja më. Shpesh kujtoja fjalët **e profesor Alaudin Kodrës** i cili më thoshte se të gozhdohesh në ndjekjen e punimeve të kërkim - zbulimit **është gjëja më lehtë për një gjeolog**, është në një farë mënyre si të mbyllesh brenda guackës dhe **të shohësh rehatinë personale** duke mos menduar për perspektivën e objektit ku punon dhe të rajonit në tërësi. Gjeologjia eshtë një shkencë që veç të tjerave kërkon edhe **guxim.** Pa guxim, **veprim e dije,** pa punë nuk ka rezultate. Këto i bluaja pa ndërprerje në kokë.

Bora akoma nuk kishte shkrire ne **Kreshtat e Malit te Korabit** ku lartësitë mbi nivelin e detit lëvizin nga **2525 m** deri ne **2754 m.** Edhe poshtë kreshtave, vende – vende kishte ishuj bore sidomos neper gropat e thella karstike ne fillimet e **Rrafshit te Korabit**, që nga vendasit thirren **Rebi.** Megjithëatë, puna duhej filluar sa më parë. Vera këtu është e shkurtër dhe koha nuk të premton për shumë punë. Do të ngrinim vetëm çadrën time italiane me ngjyrë jeshile dy-vendëshe. Punëtorët nuk do ti sistemonim nëpër çadra jo vetëm për faktin se nuk kishim mundësi organizative, por dhe per faktin tjetër se, ato do të ishin të gjithë **nga Tejasi,** fshati më i afërt malor i Kalasë se Dodës me zonën e punimeve, me mundësi për tu kthyer në darkë pranë familjes. Në rikonicionin që kisha bërë disa ditë më pare, pata caktuar vendin e ngritjes së bazës, afër baxhos së **Rasim Shehut.** Nuk kishim nevojë të linim roje duke qenë pranë baxhos, pranë njerzëve të saj të mirë e besnik.

* * *

Me baxhierin na kishin njohur vështirësitë e jetës. Na njohën e na bashkuan malet. Atë verë në baxho punoi djali i tij **Imeri**, por ne ishim mësuar ta thërrisnim me emrin **e Rasimit**, këtij njeriu serioz e zemër mirë, që një jëtë të tërë punoi ketyre anëve me ndershmëri e përkushtim në përpunimin e qumshtit të maleve më të larta të Shqipërisë. Po ashtu dhe Imeri, **mëshironte vyrtutet e të atit**, një njeri i qeshur e kurajoz, një njeri korrekt me të gjithë fshatarët. Ndërsa e pyesja për cilësinë e qumështit të këtyre anëve, ai më përgjigjej me fjalët: Qumështi eshtë shumë i mirë, **qumësht Korabi kur i thonë**, por bjeshkët tona më të mira janë matanë kufirit inxhinier, matanë qafës së Rosnikut- më drejtohej shpesh me një **farë zemërimi dhe nostalgjie** per to. Unë e dija se viset shqiptare ishin coptuar, por bjeshkët me sy në ato anë nuk i kisha parë ndonjëherë që ta ndjeja si Imeri **inatin e të qënurit të tyre jashtë kufijve të Shqipërisë**. Kur mu dha mundësia e shkova në ato vise Shqiptare, **si gjeolog**, thashë me vehte: Ah sa të drejtë paska patur Imeri. **Unë jam mahnitur** kur i kam parë nga afër bjeshkët e pa-anë e ato pyje të virgjëra në tërë kuptimin e fjalës. Nga maja e Korabit i kisha parë vetëm me dylbi. Jam habitur midis të tjerave, kur ne afersi të **Gurit të Zi (Crni Kamen)**, aty ku fillon e merr formë **përroi i famshëm i Radikës,** kishte dhe **një xhami**. Ishte ndërtuar për të falur të **xhumanë** besimtarët islam. U habita, por, dhe u gëzova shumë. Të them të drejtën në Shqipëri nuk kam dëgjuar që të këtë xhami ne bjeshkë.....! Mu kujtua **xha Rasimi (Xha Hamdiu e sa e sa të tjerë.....)** i cili do të ishte ndër të parët që do të falte të xhumanë në këtë xhami, po të mos e pengonte **kufiri dhe sistemi**! Mu kujtua gjithashtu kur falej të premteve nën hijen e **Kasollës së Baxhos** në Rrafshe, me lëkuren karakteristike **të deleve rud** si shtroje, por jo në xhami! Më qe lutur dhe mua disa raste që të faleshim bashkë por unë nuk pata pranuar...! **Eh,** tani të paktën një pjesë e **këtyre bjeshkëve madhështore dhe xhamia janë** të Kosovës, të Shqiptarëve dhe të Goranëve, **ngushllova vehtën.....!**

* * *

Reth orës shtatë të mëngjezit poshtë sektorit vura re se po vinin kafshët. **Bajram Daku, një sondist i shkathët e sy shqiponjë kur i thonë**, i kishte lidhur në atë mënyrë hajvanët, duke i komanduar nga kali që kishte preferuar ti hypte e të printe karvanin. Dukej sikur po fluturonte. Së bashku me disa punëtorë që flinin në sektor dhe guzhinierin, i ngarkuan mirë e mirë të gjitha materialet që kishim bërë gati. Kishte pergatitur dhe disa trarë druri të hollë (shkopinj) për të shtërnguar çadrën. Unë kisha harruar ta porosisë për to, por njerëzit që e njohin punën kujtohen për gjithçka dhe të nxjerrin faqebardhë. As në shkollë të them të drejtën nuk kishim mësuar për ngritjen e çadrave. Nevoja na mësoj gjatë jetës. Të lumtë Njazi- iu drejtova atij për ta falenderuar. Ne Rrafshe nuk ka pyje, ndaj më vajti mendja për ti pergatitur vetë. U kujtova –vazhdoj përsëri bisedën Njaziu, pasi kur ngritën për herë të parë **çadrat në Kijavec**, ne kodrën e bukur me Mështekna në Ploshtan, ne i shternguam ata me trarë (të përafërt me hunjët e gardhit) që të mos i lëviz e rrëzoi era. Ndërkohë që kafshët u ngarkuan dhe po bëheshim gati për tu nisur, guzhinier Agimi na kujtoj të ngarkonim dhe disa ushqime kryesore. Nuk dua ti permend emrat e tyre se për brezat e sotëm menuja jonë e shqimit të asaj kohe do te duket e pabesueshme. Kështu ishin mësuar ne, njerëzit e maleve, të punonim në kushte të tilla që **sot as që shkohen ndërmend.** Pas dy orë udhëtimi nëpër shpatin perendimor të malit të Sorokolit arritëm në Rrafshen e Korabit, në këtë vend turistik malor që ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve të fushave të ndryshme për bukuritë natyrore dhe vlerat kullosore për blegtorinë, per tufat e deleve rudë, per stanet..... dhe për kengën prekëse te Kurbetit të kënduar nga bilbili i kengës popullore Dibrane, Artistja e Meritуar **Liri Rasha** (Jushi). Në Rrafshe, në vendin ku do të ngrija çadrën, kishin arritur perpara nesh dhe punëtorët e punimeve sipërfaqësore që do të hapnim atë verë. Midis tyre dallova dhe **Zjarmëtarin Safat Hoxha.**

* * *

Safati banonte në fshatin Tejas, fshati me kuotë më të lartë mbi nivelin e detit midis pesë lagjeve të vjetra të Radomirës në emërtimet e hershme. Me të kisha kohë që njihesha gjatë punës ne malet e Korabit dhe Sorokolit. Me kalimin e viteve ai do te zinte një vend të veçant, në marrëdhëniet e mija me punëtorët e ekipit te Hekurit, atë të Polimetaleve dhe më vonë të të gjithë Ekspeditës se Peshkopisë, kjo fale humorit që e karakterizonte, fjalëve të tërthorta që përdorte në biseda (alegorisë) dhe rrethanave të tjera miqësore që më lidhnin me këtë njeri. Ishte i zeshkët, me trup mesatar dhe me flokë të plota që nuk kishin ndërmend ti binin, por vetëm i forcoheshin e i ashpërsoheshin. Pamjen e kishte te vrazhdët, por kur hyje në bisedë me të, ai fillonte e **"zbardhej"** në fytyrë dhe kur i vinte rradha për të folur vështirë se i'a lëshonte më rradhën ndonjë tjetri. Pse bën kështu Safat **-mundohesha në të rrallë ta kritikoja**, dhe ai, me humor dhe **hazër xhevap** me thoshte –unë di të bëjë muhabet inxhinier...vazhdonte duke renditur lloji – lloji argumentesh për të na mbushur mendjen në të drejtën e tij të fjalës**. Bukuria e njeriut është bukuria e fjalëve që flet, pjekuria e njeriut kuptohet nga punët e drejta që bën.** Këtë ma ka thënë Mulla Basria i Kullasit (Çernjevës). Po more Safat po -i drejtohesha me të butë unë, ashtu siç të ka thënë Mulla Basria eshtë, por bukuria e fjalëve nuk lidhet me sasinë e tyre, lidhet me cilësinë. Dakord inxhinier- më kthehej përsëri, unë sipas teje **sasi** flas. Edhe sasi edhe cilësi Safat, të dyja së bashku –ia ktheja me të qeshur unë. Edhe ty nuk të kuptohet muhabeti inxhinier –vazhdonte bisedën Safati, kështu e keni ju Çidhnakët, vetëm muhabet me kunja dini të beni. Nuk thonë kot, ç'pjellë nga macja, gjuan mijë.

Të them të drejtën Safati nuk ishte ndonjë punëtor i madh. As ndonjë shkollë të madhe nuk kishte. Kishte zgjuarsinë natyrale, pervojën e jetës dhe në veçanti të pjesës së kurbetit, pasi shumë vite kishte punuar larg familjes, në puset e naftës ne zonën bregdetare. Për të vënë të tjerët në punë ishte më i aftë se sa të punonte vetë. Profesioni i zjarmëtarit i shkonte për shtat pasi nuk kishte lodhje të madhe fizike. Pikërisht këtë të fundit ai nuk e kishte qejf shumë. Tek shtëpia e Safatit si tek shumë e shumë të tjerë **shkoja në të rrallë duke e ruajtur masën.** Në përgjithsi krahina e Kalase se Dodes eshtë një zonë e vuajtur shume, veçanërishtë e lodhur nga klima malore me dimrin e gjatë dhe të ashpër. Kësisoj shtegëtimi i bagëtive në periudhën e dimrit **ishte domosdoshmëri**. Edhe punimet tona gjeologjike ne periudhën e dimrit reduktoheshin shume. Një pjese e mirë e punëtorëve sistemoheshin ne ekspeditat e Bulqizës. Patë rastisur një dimër që dhe Safati të punonte atje. Në punë e sipër gjatë periudhës dimërore në Bulqizë, ishte takuar me drejtorin e asaj kohe dhe kishte zhvilluar bisedën e mëposhtëme: **A e dëgjove Safat se Partia ka marrë vendim të ndalojë shtegëtimin e bagëtive** të Lumës. Pasi ishte menduar pak i kishte dhënë këtë përgjigje: Po shoku drejtor e mora vesh, por - kishte shtuar Safati - Ju a e morët vesh se Partia ka marrë **dhe një vendim tjetër?** Për çfarë vendimi e kini fjalën Safat -i ishte drejtur ai si me habi duke pritur pergjigjen? Për vendimin e ndalimit **te shtegëtimit edhe të njerzëve të Gollobordës** -i kishte thënë Safati! **Si the, si the Safat** – i kishte kerkuar sqarim Drejtori? Partia kishte marrë dy vendime, për të ndaluar shtegëtimin e **Bagëtive të Lumës dhe Njerzëve të Gollobordës**. Më ofendove Safat – i ishte drejtuar përseri drejtori i ndërmarrjes **me një ton zbutës dhe me nje qeshje të lehtë nën buzë,** por, mirë ma bëre, se vetë u ngacmova -e kishte mbyllur bisedën ai. Ndoshta drejtori mund ta kishte patur me shaka dhe as që mund ta kishte menduar atë përgjigje, por Safati e kish marrë shumë seriozisht pyetjen. **Ishte me sedër**, si gjithë njerëzit e Kalasë së Dodës dhe nuk duronte asnjeri **që ta nëpërkëmbte**, me postin apo autoritetin e partise, **zonën e Tij**, të përçmonte kujdesin e tyre për punën me delën rudë. Ne nga halli e bëjmë shtëgëtimin, nuk e bëjmë nga qejfi përsëriste shpesh Safati. Bagëtia eshtë si fëmija dhe ne ashtu i kemi trajtuar gjithë jetën. Nga halli flejmë jashtë, pranë tyre, maleve e fushave të Shqipërisë, në shi e në borë, ditën dhe natën.

Ndërsa sillja ndërmend këto kujtime, për të plotësuar disi shënimet e mbajtura në ato vite, më vajti mendja tek libri që sapo kam lexuar kohët e fundit (dhuratë nga shoku i fëminisë, talenti i poezisë **Ilir Lazim Spata, ish nxënës i shkrimtarit dhe studiuesit të spikatur Xhafer Martini**), ku, midis të tjerave, në librin "**Legjenda e Nje Fisi", vargëzon pjesen kur Demir Lusha i vjetër nga Arrasi, në bisedë e sipër nuk pranon që Veziri i Shkodrës ta shpërblejë personalisht me para per meritat që kishte, por i kërkon atij ndihmë për ndërtimin e Urës se Lushës në Krahinën e Çidhnës, për të lidhur dy brigjet "Ku mblidhet , tkurret, Lumi i Zi":**

Vezir i Naltë
Ty t'u shtoftë ndera!
Për vehte s'due
Besa një grosh!
Jam derë sojlie,
E ma don sëra
Ta ruaj nderin
Me xhepat bosh.

Vertet me xhepa bosh e ka ruajtur nderin ajo krahine. Për këtë jam krenarë edhe unë pasi ndjehem si bashkëfshatar i asaj krahine, ndjehem me fat që mu dha rasti të punoja e jetoja një pjesë të jetës time, të rinisë, në ato anë, mes atyre njerzëve të thjeshtë, në ato bjeshkë e male të lartë e me bukuri të rrallë të cilat në anën profesionale përfaqësojnë një laborator të "gjallë" të gjeologjisë Shqiptare.

Disa vite me vonë kur nuk punoja ne Korab, më rastisi të shkoj në këto anë me një profesor të nderuar dhe njëkohësisht mikun tim Zotni **Selam Meçon**. Patën rastin që në përfundim të punimeve fushore një natë ta kalonim në shtëpinë e Safatit. Kishte marrë vesh se kemi ardhur dhe na dërgoj djalin, Bilbilin, **që të na ftonte**. Kur unë e prezantoj në detaje per profesionin e profesorit të respektuar, duke i shpjeguar se ky mes të tjerave merret me percaktimin e moshes së shkëmbinjëve, ai, me humorin e hollë iu drejtua atij duke i thënë: **Mos u lodh shumë me këtë punë profesor, se e din Zoti, se sa të vjetër janë gurët e maleve**. Profesori po me të qeshur ju pergjigj: Unë nuk jam ndonjë besimtar i madh dhe nga feja nuk kam dijeni por, shtoj profesori, kam dëgjuar nga njrëz të shkolluar të fesë islame se **shkenca dhe zanati** janë gjëra që **i kanë humbur njeriut**, **besimtarit**, dhe ai duhet ti marrë kudo që ti gjejë. Dakord, dakord profesor-**tha Safati** i cili dukej se nuk e priste atë përgjigje. Në bisedë u futa dhe unë duke i thënë se profesori të dha nje përgjigje të **goditur,** një pergjigje islame. Me shkencëtaret **duhet patur kujdes Safat**. Ata lexojnë e studiojnë shumë, prandaj e fitojnë parashtesën profesor, para emrit. **Boja e dijetareve peshon më rëndë se gjaku i shehidëve (dëshmorëve)** -thuhet në hadithin Sherif, vijova unë duke e mbyllur temën e bisedës. Tregimet për Safat Hoxhën nuk kanë të mbaruar. Tani jeton në Tiranë dhe ka dalë në pension. Sa i perket muhabetit akoma nuk ka dalë në pension dhe nuk dihet kur del. Ky ishte në pak rrjeshta Safat Hoxha i Tejasit.....

(Vijon)

* Autori i shkrimit është **antar i senatit akademik** të Universitetit Politeknik të Tiranës. *Titulli i shkrimit është i redaksisë*

Rruga Arbërit nr. 43
histori

Si i njoha Izet Dibrën dhe Faik Shatkun

Raportet Politike të Mehdi Frashërit me Izet Dibrën* (Shatku)

Në librin me titull ***"Kujtime"*** të Mehdi Frashërit, në të cilën përfshihen, ngjarjet, nga viti 1918-1933, me mbresat, raportet, korespondencat me zyrtarë të kohës, si dhe angazhimet politike dhe diplomatike të një politikani dhe diplomati karriere, në dobi të kauzës Shqiptare në arenën ndërkombëtare, jepen ndikimet si dhe lidhjet që **Mehdi Frashëri**, kishte për politikën e brëndshme në Shqipëri. Ja se c'shkruan Mehdiu në lidhje me Izet Dibrën. "Izet Dibra ishte nënprefekt i kryeqytetit. Në Tiranë u shpall shtetrrethimi dhe u krijua menjëherë gjykatorja ushtarake, për të hetuar dhe gjykuar fajtorët e lëvizjes. Midis këtyre ndodhej edhe Abdi bej Toptani, i cili disa ditë më parë se të ngjante lëvizja e **Elez Jusufit, Xhafer bej Ypit,** i kishte cuar një kartëvizitë ku i thoshte se kishte marrë vesh se po bëheshin pregatitje për një kryengritje, pa dhënë shpjegime të tjera. Kurse informatat e qeverisë, mbasi plasi pushka, ishte ndryshe, d.m.th. se Abdi beu, si dhe Aqif pasha në Elbasan, kishin haber për këtë kryengritje. **Izet Dibra,** bënte hetimet e Abdi beut. Unë vajta e u poqa me Izet Dibrën, dhe e pyeta rreth kësaj çështjeje, i cili më tha se, simbas dëshmisë së një djaloshi katundar, Abdi beu ishte kompromentuar me kryengritësit. Por, megjithatë, kartëvizita që mbante Xhafer Ypi, na vinte në dyshim dhe kështu unë ndërhyra pranë Ahmet beut për të mos e dënuar **Abdi beun**, por ta linte të lirë të shkonte jashtë Shqipërisë. Mbas shumë bisedimesh ndërmjet meje dhe Abdi beut, u vendos që Qemal bej Delvina të merrte Abdi beun dhe ta conte në Durrës, dhe mbasandej të shkonte në Vjenë. Ndërsa, **Mustafa Ndroqi** u kap dhe u soll në Tiranë për t'ia dorëzuar Gjyqit Penal Ushtarak".

Izet DIBRA (SHATKU)
(19.05.1877- 11.02.1964)

Në foto: Faik SHATKU, kur ishte Ministër i Drejtësisë.

Raportet Juridike të Mehdi Frashërit me Faik Shatkun

Marrdhënie midis Mehdiut dhe Faikut ishin tepër të ngushta dhe intesive, jo vetëm në kuptimin shoqëror e politik, por sidomos në lëmin jurisprudencial. Ato u zgjeruan dhe më tej kur Faik Shatku, i propozoi Mehdi Frashërit, që të ishte dhe ai anëtar i komisionit kodifikues që do të merrej me përgatitjen e kodeve të reja ligjore me frymë perëndiomre. Kurse me krijimin e Këshillit të Shtetit, Mehdi Frashëri ishte kryetar i saj, dhe Faik Shatku ishte nënkryetar i këtij Këshilli Konsultativ Kolegjal, që luajti një rol tepër me rëndësi për kohën. Ja se cshkruan Mehdi Frashëri në lidhje me krijimin e këtij komisioni: "Në vitin 1926 në Ministrinë e Drejtësisë ishte formuar një komision për të hartuar një Kod Penal të ri, për shtetin Shqiptar. Atëherë ministër i Drejtësisë ishte **Petro Poga,** dhe këshilltar i Ministrit te Drejtësisë ishte Faik Shatku. Një ditë kur fjalosesha me Faik Shatkun, i thashë se është e mira që të hartoheshin jo vetëm Kodi Penal, por të pesë Kodet, d.m.th. edhe kodi civil, kodi tregtar, procedura civile dhe procedura penale. Më i zorshëm dhe më i madh ishte kodi civil. Faiku më tha se po të pranoja dhe une të merrja pjesë në komision, do të bënte hapat e duhura me anën e Ministrisë së Drejtësisë për formimin e komisionit kodifikues (ligjpërgatitités). Faiku më pyeti nëse dija ndonjë shok tjetër të aftë, për të marrë pjesë në komisionin e lartëpërmëndur. Unë, meqënëse kisha njohur Thoma Orolloganë në Paris, shënova emrin e tij. Ministria e Drejtësisë zgjodhi edhe Agjah Libohovën, atëherë avokat ne Vlorë. Më 1927 u formua komisioni ligjpërgatitës me dekret mbretëror, i përbërë prej katër personash. **Thoma Orollogaj, Agjah Libohova, Faik Shatku dhe Mehdi bej Frashëri**."**

Këto katër personalitete, konsideroheshin si juristët më të mirë të vëndit, por dhe që njihnin më së miri doktrinën e së drejës së krahasuar, si dhe njëkohësishtë dhe kodet Europiane në zbatim. Më 3 Qershor të 1927, u miratua Kodi Penal Shqiptar, si dhe ligji mbi aplikimin e Kodit Penal, të cilët ishin votuar më parë nga parlamenti dhe senati. Të dy aktet e mësipërme hynë në fuqi më 1 Janar 1928. Kodi Penal Shqiptar zëvëndësoj Kodin Penal turk të vitit 1878 (1274 sipas kalendarit të vjetër turk). Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Kodit Penal, shteti shqiptar ka ligjin e vet penal si burim kryesor të së drejtës penale në këtë periudhë historike. Ky kod i kodifikuar dhe i sistemuar nga juristët më të mirë të kohës në Shqipëri, u bazua në modelin e Kodeve Penale të shteteve Europiane, e më konkretisht duke pasur si model kryesor Kodin Penal të Italisë të vitit 1889, si dhe legjislacionin juridiko-penal të shteteve të tjera të Europës, rreth disa Instituteve penale të cilat nuk i përmbante Kodi Penal i Italisë. Në librin " ***Kujtime*** " në faqen 218-të, Mehdiu kujton: "Vitin 1928, shkoi me përgatitjen e kodit civil. Ky punim vazhdoi edhe në muajt e parë të vitit 1929, derisa u formua Këshilli i Shtetit me kompetencën që të plotësonte kodet dhe të shqyrtonte ligjet e rregulloret që do të hartonte shteti. Në muajt e parë të 1929 komisioni ligjpërgatitës hartoi dhe shtojcën e procedurës civile. Në muajin prill të këtij viti u emërova kryetar i **Këshillit të Shtetit, duke pasur për shokë Martin Ivanajin, Kristo Flloqi, Faik Shatkun nënkryetar, Demir Villën, Ajet bej Libohovën, Shefqet Frashërin, Kosta Cekrezin e Sali Toron**. Simbas statutit të Këshillit të Shtetit, meqënëse ky institut kishte iniciativën e kodeve, filluam punën për hartimin e një e Kodit Tregtar Shqiptar. Meqënëse unë kisha eksperiencën e gjatë të karrierës, hartimi i projektit mu ngarkua mua prej shokëve, prandaj propozova projektin e komisionit italian të posacëm që ishte formuar nën kryesinë e **Profesor Vivantit**. Kodi Tregtar Italian ka pasur një famë në të gjithë botën e juristëve dhe projekti i ri i Vivantit, filluan kundërshtimet, simbas zakonit, në të katër anët me pretekste se ky kod i ri nuk do të kishte komente dhe zbatim në vend. Ndër cështjet më të rëndësishme që janë diskutuar nga anëtarët e Këshillit të Shtetit, kanë qënë, ajo e reformës agrare në vënd si dhe projektligji i dërguar nga qeveria rreth mësimit fetar në shkollat publike".

Përgatiti. **SAIMIR SHATKU**

* Llagapin **Dibra**, Izeti Shatku e ka mbajtur si nostalgji dhe respekt për vendlindjen e tij, Dibrën e Madhe, që aq shumë e deshte dhe e lavdëronte në mexhlise dhe në kuvend. Por fatkeqsishtë pushtimi i saj nga trupat serbo-malazeze, bënë që një sërë familjesh Dibrane, ku ndër to dhe familja Shatku, të linin vëndin e tyre, dhe të emigrojnë. Një pjesë për në Turqi dhe pjesa tjetër për në Shqipëri. Pseudonim Dibra, Izet Shatku, e ruajti dhe kur ishte Ministër i Punëve Botore (1929-1933), si dhe kur ka shërbyer si Deputet, Prefekt dhe Kryetar Bashkie në një sërë qytetesh të Shqipërisë. Kjo gjë pasqyrohet dhe në librin historiko-politik, të historianit gjerman Michal Schmid-Neke me titull, *" Ngitja dhe Rënja e Mbretërisë Shqiptare (1928-1939)"*. Botuar në Gjermani, Oldenborg më 1978.

** Ref. në librin " Kujtime" të Mehdi Frashërit, faqa 218-225, Tiranë 2005.

*** Izet Dibra (Shatku) dhe Faik Shatku janë fëmijët e Murat Ibrahim Shatkut. Ky i fundit ka qënë tregëtar dhe financier në Dibër të Madhe.

Pajtohuni
në gazetën
"Rruga
e Arbërit"

www.dibra.org

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

Pajtimi në gazetë kushton 600 lekë në vit
*dhe gazeta ju vjen me postë në shtëpinë tuaj**

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për të pritur letrat e lexuesve për problemet dhe shqetësimet e tyre.

Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.

Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.

Tel. (04) 22 33 283. E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.
* Për ata që duan që gazeta t'ju shkojë me postë në shtëpi, ju lutem konfirmoni në redaksi adresën e saktë

Foto: B. Karoshi

Përse nuk u festua 60 vjetori i shkollës pedagogjike të Peshkopisë?

Nga: Shaqir Skarra

Ufol gjatë e u shkrua atëherë edhe në media se 60 vjetori i shkollës pedagogjike të Peshkopisë do të festohej me madhështi. Maturantët e parë ishin mbledhur disa herë radhazi në Tiranë, ishin takuar njëri me tjetrin, ishin çmallur, kujtonin ato vite të bukura si nxënës në shkollë, derdhnin edhe lot për ato shokë e shoqe që mungonin mes tyre. I kishin festuar së bashku përvjetorët e shkollës jo vetëm në Tiranë por dhe në Peshkopi. Ndryshe nga herët e tjera 60 vjetorin kishin vendosur ta festonin disi më ndryshe. Nuk i thonin pak por plot gjashtëdhjet vite kishin kaluar që atëherë. 60 vite më parë shkolla pedagogjike e Peshkopisë mblodhi nxënës nga zonat e veriut dhe lindjes duke u bërë kështu fidanishtja e parë për mësues në këto anë. Ende sot pas kaq vitesh kjo shkollë kujtohet si një nga shkollat me një përvojë mjaft të pasur në historinë e arsimit shqiptar. Gjashtëdhjet vite nuk i thonë pak. Janë plakur, disa ende janë në punë e shumë të tjerë mungojnë mes tyre. Ndaj për këtë përvjetor u angazhuan të gjithë që festën e bukur të tyre ta festonin në qytetin e Peshkopisë, në atë qytet ku kishin kaluar vitet më të bukura të jetës së tyre rinore. Përvjetorët e kësaj shkolle ishin festuar çdo vit ku bashkë tok ish nxënës por dhe ish mësues e drejtor të kësaj shkolle ishin çmalluar me njëri tjetrin ku kujtimet kishin rrjedhur për ato vite vërtet të bukura. Ndaj dhe këtë radhë puna nisi me seriozitet dhe përkushtim që ky përvjetor të kishte vërtet të veçantën e përvjetorëve të tjerë që ishin festuar deri tani. Shkrimtari i njohur dibranë dhe një nga ish nxënësit e kësaj shkolle Xhafer Martini botoi edhe një libër me kujtime me titull"Pedagogjikasit" Ish drejtor dhe ish nxënës të kësaj shkolle filluan të shkruajnë në faqet e gazetave ku gazeta"Rruga e Arbërit" dhe "Dibra" botuan disa numra radhazi shkrime nga Astrit Hoxha, Shemsi Manjani, Enver Hysa, Shefqet Hoxha, Lutfi Hanku e plot të tjerë. U bë vërtet një punë e madhe pregaditore për të festuar këtë 60 vjetor. Qyteti do të gdhihej si gjashtëdhjet vjet më parë në bulevard me pedagogjikasit por jo më me fëmijë por me pleq flokëbardhë ku duke i tërhequr këmbët me kujdes e dikush, dikush dhe me bastun do të ngjiteshin ndoshta edhe nëpër ato rrugica që kishin shkelur vite ma parë. Shkolla pedagogjike e Peshkopisë si një nga shkollat e para të zonës verilindore për mësues ka qenë dhe mbeti një përvojë mjaft e pasur në fushën e arsimit shqiptar. Në ato vite me të drejtë e quanin"Universitet". Nga bangot e kësaj shkolle kanë dalë kuadro që kanë drejtuar dhe vazhdojnë të drejtojnë sektorë të ndryshëm të vendit tonë si diplomat, pedagogë, inxhinier, mjek e ushtarak. Shteti investoi për këtë shkollë por ama edhe ato kuadro që dolën nga bangot e kësaj shkolle e përligjën investimin e shtetit duke u bërë të aftë të drejtojnë sektorë të ndryshëm të vendit tonë dhe jo vetëm në arsim ashtu siç kishte profilin shkolla pedagogjike. Thënë më troç kjo shkollë ishte dhe mbeti krenari e Dibrës dhe dibranëve e kishin të drejtë të mburren jo vetëm dibranët por të gjithë ato që mësuan në këtë shkollë, që përfituan përvojë mjaft të pasur e dije të plota. Kaluan ditë e muaj, kaloi viti e nga qyteti i Peshkopisë nuk po vinte asnjë sinjal se kur do të festohej 60 vjetori i shkollës pedagogjike. Edhe kur pyesnin njerëzit që ishin marrë me këtë organizim, si nën zë ngrenin supet dhe nuk dinin se si të përgjigjeshin. Shkurt heshtja e tyre fshihte diçka të papëlqyer por askush nuk jepte detaje se pse dështoi së festuari 60 vjetori i shkollës pedagogjike. A mos vallë ishte një hakmarrje primitive si ato që rëndom ndodhin në Dibër ku për inat të sime vjehërr, po shkoi të fle me mullixhinë. Pak rëndësi ka se kush ka qenë në pushtet në atë periudhë. E rëndësishme është se qytetit të bukur të Peshkopisë i dhanë një shkollë që u fut në histori si shkolla që po nxirrte mësuesit për zonën verilindore të vendit. Nuk mund të hamendësojmë sot për "harresën" e këtij përvjetori por siç tregojnë nën zë ngjarje të tilla nuk paskan qejf që të kujtohen më. Kështu siç po ndodh edhe përvjetorët po përvetësohen dhe po mbeten në duar të pushtetarëve. Në Peshkopi bile flitet se dhe arsimtarët janë privatizuar. Pak rëndësi ka se sa vjet pune kanë e ku janë shkolluar. Intelektualët flaken në rrugë pa mëshirë e militantët ngjiten në detyrë. Shteti ka investuar për të shkolluar njerëzit e ja këtu me një të rënë të lapsit i gjithë ky investim shkon dëm. Kështu ndodhi dhe me këtë përvjetor të shkollës pedagogjike ku me të drejtë mburret e gjithë Dibra. Mburren edhe ato flokëbardhë që mësuan për katër vite me radhë, që përfituan dije sikur të kishim mbaruar një fakultet. Në Peshkopi është bërë një traditë e bukur që mblidhen shpesh njerëzit për festa e përvjetor, mbushet salla e pallatit të kulturës plot për plot qoftë për një promovim libri apo një ditëlindje. Në raste vdekje e veçanta e qytetit është se kortezhi zgjatet e zgjatet pambarim. I bashkohen këtij kortezhi edhe njerëz të panjohur. Kjo ndodh vetëm në Peshkopi. Janë mbledhur tok së bashku për ngritjen e një monumenti apo busti, në përurimin e një vepre apo emërtimin e një rruge, për një koncert festiv apo dhe për pritjen e një mysafiri të ardhur nga larg. Për të kujtuar tok së bashku 60 vjetorin e shkollës pedagogjike të Peshkopisë nuk u mblodh askush. Atyre që ju takonte të merreshin me këtë aktivitet bënë sikur harruan. Edhe pse një investim i madh e dobiprurës për fushën e arsimit ja që në Peshkopi kjo datë "harrohet". Të jetë vërtet harresë? Nejse këto ndodhin në Peshkopi.

Arsimi në Lurë

Nga: **ALI KOÇEKU**

Populli i Lurës ka qenë gjithmonë i etur për dije e arsim. Ka mjaft dokumenta që flasin se djem nga Lura janë shkolluar herët në Stamboll, Zvicër e Itali. Nga këto mund të përmendim Dom Gjon Zotaj(Lura), Dom Gjon Hoti, Dom Nikollë Kaçorri i cili kishte përfunduar tre fakultete. Thuhet se dhe Doçi i Lurës kishte dërguar një djalë në Stamboll për ta shkolluar. Lurasit pra edhe gjatë sundimit turk kanë bërë përpjekje të vazhdueshme për tu shkolluar si dhe për të hapur vetë shkollën shqipe dhe ia arritëm qëllimit. Xhonturqit meqëllim që ta pengonin këtë nismë që të mos vazhdonte gjatë shkolla e Lurës dërguan mësues një hoxhë për të mësuar turqisht nxënësit që ishin rregjistruar në të parën shkollë në Lurë. Mjaft burra të njohur nga Lura ia ngarkuan librat turqisht mësuesit Haziz Kadiu nga Mati në shpinë dhe nuk e pranuan që të jepte mësim në gjuhën turke. Me rastin e shpalljes së pavarsisë u mundësua edhe hapja e shkollës së parë shqipe në Lurë. Ishte pikërisht patrioti e atdhetari i flaktë Nikollë Kaçorri i cili i jepte porosi Shyqyri Koçit në Mat që veç Matit të ngrihet flamuri i pavarsisë dhe të hapet shkolla edhe në Lurë. Kjo porosi i vinte Shyqyri Koçit me anë të djemve lurianë Bibë Koçeku e Ndue Kaçorri. Vetë patrioti Shyqyri Koçi bashkë me dy djemtë nga Lura në mes të atij dimri të sertë arrijnë në Lurë në dhjetor të vitit 1912 dhe në mes të një entuziazmi të madh ngrejnë flamurin dhe hapin shkollën shqipe. Mësues i parë i kësaj shkolle erdhi Kolë Bibë Doçi i cili ishte arsimuar në Shkodër. Ishte pikërisht ai dimër i vështirë si dhe dyndja e ushtrisë serbe që shkolla e parë shqipe e Lurës të mos ketë jetë të gjatë. Edhe pse shkolla e parë u mbyll, populli i Lurës nuk i pushoi kërkesat e tyre për arsim. Pas Kongresit të Lushnjes, deputeti Hasan Prishtina më 10 shtator 1921 i drejtohet Parlamentit: "…Sikurse e dini zotnia juej Shqipëria ka nevojë të madhe për shkolla, sidomos ndër malsina. Unë jam i bindur, se lipset dhanë randësi hapjes së shkollave në malsitë ku mungojnë krejt. Arsimi asht shpirti i një kombi…Andaj lutemi që Ministria e Arsimit, me një dëshirë të plotë të marrë masat e nevojshme për të hapur një orë e ma parë një shkollë-internat në Lurë me të paktën 100 nxënës. . . " Qeveria nën presionin e deputetëve patriot dhe të kërkesave të vazhdueshme të populllit u detyrua të hap shkollën e parë në Lurë më 10 prill 1922. Lokal nuk kishte, por plaku Dali Koçeku vuri në dispozicion të fëmijëve shtëpinë e tij vullnetarisht. Nxënësit e parë që u rregjistruan në shkollë ishin: Istref Kaci, Ketë Kaci, Man Mena, Dali Nura, Gjokë Rajta, Tahir Mena, Ibrahim Kaci, Rrem Tollja, Ibrahim Koçeku, Hasan Hazizi etj ku klasa kishte 43 nxënës. Mësuesi i shkollës kishte pikëpamje demokratike, ishte një mbështetës i flaktë i Fan Nolit, kështu që në vjeshtën e vitit 1923 e arrestuan e në vend të tij sollën Shefqet Tetovën. Shkolla u mbyll përsëri shpejt dhe u deshën vite të tëra e pas shumë kërkesash të vazhdueshme që në Lurë të hapej përsëri shkolla shqipe. Në vitin 1934 u dha një fond për të ndërtuar ndërtesën e shkollës së re. Në verën e vitit 1935 u ngrit godina e re e në mes të entuziazmit të madh të populllit të Lurës që ishte mbledhur, kryetari i komunës tha:"Qeveria e Naltmadhnisë i dhuroi këtë shkollë populllit të Lurës që do të mbaj emnin e patriotit të Pavarsisë Nikollë Kaçorri". Disa nga paria e Lurës nuk e dinin se kush ishte ky patriot dhe pas disa ditësh pllakën që mbante emrin e shkollës e thyen. Ato pretendonin se duhej të ishte vetë nga paria e Lurës emri i shkollës së re. Në gusht të vitit 1935 shkolla do të priste nxënësit ku kishte ardhur dhe mësuesi Mustafa Shahini nga Trebishti i Gollobordës për të cilin ruaj kujtime e respekt të veçantë. Vërtet në Lurë ishte një ditë feste. Mësuesi lexoi emrat e 42 nxënësve dhe i ve në rrjesht. Pati brohoritje e të shtëna me armë siç tregonte vetë mësuesi vite më vonë. Mësuesi kishte sjellë vetë dhe libra me vehte por ato libra nuk mjaftonin për të gjithë nxënësit kështu që shumicës ua diktonte dhe ato mbanin shënime. . Mësuesi punonte para dite e pas dite pasi ishin shumë nxënës. Pas dy vitesh vjen mësuesi Gjergj Bullati nga Shkodra. Ky punoi në shkollën e Lurës dy vjet pastaj në vend të tij erdhi Hamdi Zabzuni e Rexhep Guraziu nga Elbasani. Në vitet e para në shkollë vijuan mësimin vetëm dy vajza nga Lura, Dile dhe Shkurte Doçi që kishin prindërit oficera. Në vitin 1942 shkolla u mbyll dhe do të hapej vetëm në vitin 1947 në Fushë-Lurë me mësues Riza Kazazin nga Tirana. Një tjetër shkollë u hap edhe në Gur-Lurë me mësues Destan Tërshana nga Dibra e Madhe. Një vit më vonë u hapën shkolla në Krej-Lurë, Armollë e Pregjë. Në vitin 1948 erdhën mësuesit vendas Jashar Kaci, Ali Koçeku, e Halit Doçi. Vite më vonë vërshuan mësuesit vendas nga shkollat e kurset si Kasem Hoti, Sali Ajazi, Xheladin Tollja, Halit Nezha, Prengë Markola, Hysen Vladi, Ramazan Përleka, Emin Hoti, Bajram Përleka, Zenel Kaci, Nezir Mena, Han Koçeku, Misim Tollja, Nazmi Kaci, Ismail Hoti, Hysni Tollja, Shkurte Tollja, Hilmi Kolgjegja, Margjela Vladi(kjo është mësuesja e parë nga Lura) Hysni Hoti, Musa Vladi, Destan Ajazi, Hamit Ajazi, Cen Vladi, Osman Vladi, Zef Vladi, Qerim Buci, Bibë Doçi, Mudë Ajazi, Rifat Hoti, Bajram Mena, Dervish Murati, Enver Buci, Zare Tollja, Mrikë Doçi, Naim Buci, Sulë Vladi, Muharrem Koçeku, Trendelina Koçeku, Shkëlqim Bruçi, Sokol Rajta, Abaz Hoti. Ndoshta autori i këti shkrimi ka harruar ndonjë emër padashje e ndaj u kërkon ndjesë singerisht. Sipas një përllogaritje të përaftërt nga Lura kanë mbaruar arsimin e lartë 160 djem e vajza. . Kanë drejtuar arsimin në Lurë si drejtor shkolle Ali Koçeku, Kasem Hoti, Sali Ajazi, Hysni Tollja, Shkurte Tollja, Rifat Hoti, Mudë Ajazi, Hamit Ajazi, Osman Vladi, Bajram Mena, Enver Buci, Abaz Hoti e Muharrem Koçeku. Thjesht për kulturë por dhe respekt pasi shumica prej tyre nuk jetojnë sot po botojmë të plotë listën e nxënësve që u rregjistruan në vitin 1935: Ahmet Përleka, Ali Koçeku, Abaz Skana, Bibë Vladi, Dile Doçi, Isa Mena, Isuf Buci, Ibrahim Tollja, Halit Tollja, Halit Tollja , Dylejman Vladi, Kimete Kërluku, Kurt Hoti, Isuf Koçeku, Halil Tollja, Hamit Buci, Hamit Hoti, Haziz Hoti, Han Hoti, Liman Bruçi, Kolë Mariseni, Hasan Kaci, Sulë Hoti, Zenel Kaci, Han Hoti , Medi Kolgjegja, Osman Leka, Mark Vladi, Ramadan Mena, Ramadan Vladi, Hasan Cuku, Riza Buci, Rrahman Deda, Mexhit Mena, Ramiz Mena , Riza Skana, Pjetër Koçeku, Miftar Doçi, Shaban Vladi, Ramadan Koçeku, Shkurte Doçi, Osman Vladi. Lura ka thesare të mëdha që duhen zbuluar. Lura kjo perlë e vendit ka qenë dhe mbetet gjithmonë arsimdashëse, ka dhënë për arsimin por dhe i ka vjelë frutet e tij. Sot djemtë dhe vajzat e Lurës punojnë në sektor të rëndësishëm të vendit duke u bërë të njohur për vlerat e mëdha intelektuale që mbartin.

Libri i Mevlud Bucit është një manual poetik trandeshent, një thirrje që i bëhet njeriut bashkëkohor, vetë epokës sonë për të ndryshuar, në përputhje me thelbin e mesazheve hyjnore

PORTRET

Gazetari dibran që intervistoi Gjeneralët e NATO-s

Nga**: XHELADIN ÇELMETA**

Ndryshimet në vend dhe në Forcat tona të Armatosura kanë qenë shumë të vrullshme në këto vitet e fundit. Pas vitit 1997 çdo gjë rrodhi aq furishëm sa që edhe kronikanët e patën të vështirë ti pasqyronin ato. Veçanërisht pas fillimit të vitit 1999 e të luftës në Kosovë, Forcat tona të Armatosura si asnjëherë në veprimtarinë e tyre u ndodhën para luftës reale, para bombardimeve në fakt, para hedhjes së minave e bllokimit të rrugëve, para vështirësive logjistike, me një fjalë të vetme para provës së madhe të mbrojtjes së atdheut.

Dhe pas kësaj lufte të madhe që nuk e pasqyron dot plotësisht asnjë gazetar e kronikan filloi lufta dhe përpjekja tjetër e Shqipërisë dhe ushtrisë shqiptare për tu integruar sa më parë në NATO. Ne e dhamë provën e bashkëpunimit me NATO-n, prandaj e merituam pranimin në NATO.

Gjatë kësaj periudhe gazetari ushtarak, që erdhi nga repartet e Bulqizës dhe të Dibrës, Sakip Cami, intervistoi gjeneralët e NATO-s, britanikë, amerikanë, italianë, turq, gjermanë etj. Ata folën sinqerisht pa diplomaci, ashtu siç dinë të flasin ushtarakët dhe tani tek sa i lexojmë intervistat e tyre ndonëse kanë kaluar kohë bindemi se ndihma e tyre ka qenë e sinqertë dhe është thithur mjeshtërisht nga ushtarakët tanë që për hir të së vërtetës duhet thënë se janë në një nivel me ta.

Kolegu im në gazetën "Ushtria" në vitet 1999-2003, ishte gazetari që intevistoi gjatë konfliktit në Kosovë gjeneralët e NATO-s, duke filluar nga Gjenerali amerikan me 4 yje Uesli Klark dhe duke vazhduar me Komandantin e AFOR-it në Shqipëri gjeneralin britanik Xhon Rith, Komandantin e KFOR-it në Kosovë gjeneralin gjerman Klaus Reinhard etj. Në vitin 2004 këto intervista dhe vizita i përmblodhi në librin e tij "Drejt NATO-s që pa dyshim është një kontribut mediatik në rrugën tonë drejt NATO-s dhe për më tej.

Pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001 në SHBA, ushtria shqiptare u rreshtua me dinjitet në luftën kundër terrorizmit duke dhënë kontribut konkret me misionet e saj paqeruajtëse në Bosnje, Afganistan, Irak etj, duke shënuar një faqe tjetër të lavdishme në historikun e saj.

Ushtria jonë në këto vite ka kaluar me sukses sfidat e reformimit e të ristrukturimit, sfidat e vënies në shërbim të popullisë civile, në përballimin e dimrit të vitit 2001, të përmbytjeve të vitit 2002, të ndërtimit të rrugëve e urave, të shpëtimit të jetës së njerëzve duke rrezikuar jetën e ushtarakëve të saj.

Gazetari ushtarak Sakip Cami ka qenë pjesëmarrës direkt në disa stërvitje shumëkombëshe brenda dhe jashtë vendit si oficer shtypi dhe informacioni dhe ka parë nga afër arritjet e ushtarakëve tanë në këto stërvitje dhe vlerësimet reale të homologëve tanë, të cilat I ka pasqyruar në shkrimet dhe librate tij.

Një vit më parë pashë në tregun e shtypit edhe një gazetë të re, gazetën "Stebleva", organ i Shoqatës "Stebleva".

Kisha lexuar edhe gazeta të tjera lokale si "Peza", "Labëria", "Orakulli i Tomorrit" etj, por kjo gazetë më befasoi menjëherë, bile më mrekulloi.

E lexova me kujdes me syrin e gazetarit dhe të qytetarit dhe vura re dallime të veçanta.

Pak, ose aspak politikë siç lexojmë rëndom nëpër gazetat e tjera, probleme të ekonomisë dhe të turizmit, histori, trashëgimi kulturore, etj këto gjeta në këtë gazetë lokale, nga më të bukurat që kam lexuar kohët e fundit. E faqosur me kujdes me letër të bardhë dhe me ngjyra, tamam si një revistë e vogël, ku fotografitë flasin njëlloj si edhe shkrimet e saj. U kënaqa pa masë edhe për faktin se këtë gazetë e drejtonte si kryredaktor i saj kolegu im, gazetari dhe poeti Sakip Cami.

Urime miku im në botime të mëtejshme.

Një rekomandim kurativ poetik kundër dhimbjes

Nga**: DUKAGJIN HATA**

Porti, studiuesi dhe qëmtuesi i vlerave etnokulturore kolektive të botës shqiptare, Mevlud Buci dallohet për depërtimin në labirinthet e fjalës, duke zbuluar në mbivendosjet e saj kuptimore dhe nëntekstet e mundshme një realitet të ri komunikimi. Qoftë në proverbat, aforizmat, njësitë e tjera frazeologjike të mbledhura odave të burrave e kafeneve, qoftë në ato të krijuara, ai përcjell një univers linguistiko-poetik latent, vetëdijen e asaj "gjuhe të harruar", siç mund të thoshte Fromi, por që është kyçi i kumteve që vijnë nga thellësitë më të panjohura të qenieve humane.

Një nga kërkuesit më të zellshëm e më të pasionuar të shpirtit poetik kolektiv, të filozofisë dhe mendësive etnopsikike popullore, Mevlud Buci në librat e tij të shumtë, të botuar në këto vite të çlirimit të letrave shqip nga barrierat jashtëletrare, na përcjell mesazhin e trashëgimisë më të qëndrueshme të shqiptarëve, asaj të fjalës së kodifikuar dhe nëntekstuale.

Në këtë libër të tetëmbëdhjetë, ai shpalos shpirtin e tij kërkimtar në të fshehtat e fjalës së mençur, të fjalës së ngjeshur ku ekstresimet kuptimore rrokin njëherësh disa kode komunikimi, duke përcjellë metaforën e një shpirti të pasur poetik, ku fjala ka peshën e vetë jetës njerëzore.

Pas librave "Metafora e shpirtit: me 1500 aforizma dhe "Ylbere mençurie" me 1030 aforizma, të cilat u mirëpritën nga lexuesi për hapësirën e komunikimit, freskinë e informacionit dhe begatinë e tematikave të përmbledhura, "Bukuria universit të besimit" është libri i tij i tretë me aforizma, një libër ku autori ka fokusuar një botë sa të njohur aq edhe të panjohur, sa të hapur e të tejdukshme aq të fshehtë e në hije, botën e besimit dhe vlerave që rrok kjo ndjenjë e fuqishme humane. Këtë botë, ai e ka sintetizuar me anë të aforizmave të krijuara, ku shkëlqen pastërtia e fjalës dhe idiomave, bukuria e shprehjes, thellësia e depërtimit psikologjik, lakonizmi dhe gjuha e zgjedhur.

Në këtë libër autori vijon kërkimet e tij të ethshme në shpirtin njerëzor, në prirjet e njeriut bashkëkohor për t'u unifikuar me hyjninë, me ana të besimit, i cili në fakt pasqyron shkallën më të lartë të vetëdijes së qenieve me ndërgjegje. Shumica e këtyre aforizmave janë të reja dhe botohen për herë të parë në faqet e këtij libri, një pjesë fare të vogël të tyre autori i ka marrë nga dy librat e tjerë, duke plotësuar më së miri gamën e problematikës që merr në shqyrtim.

Si në të gjitha vështrimet e tij krijuese mbi natyrën njerëzore, edhe në këtë libër sundon zhbirimi i hollë në psikikën e njeriut bashkëkohor, dyzimet e këtij njeriu dhe të vetë shoqërisë që ia ushqen frymën e dyzimit, konflikti mes dukjes dhe thelbit, mes asaj që thuhet dhe asaj që bëhet, mes fjalës dhe veprës, mes besimit dhe veprimit etj.

Ky libër është fryt i përpjekjeve të vazhdueshme të autorit, në bazë të

përvojave vetjake, kontakteve të shumta me botën e leximeve dhe kokë më kokë me njerëzit, për të shpalosur një semantikë poetike që e ngre nivelin e dialogut dhe të komunikimit në përgjithësi në kuota të epërme.

Në këto proverba shpaloset e vërteta e doktrinave fetare në raport besimtarët dhe jobesimtarët, fryma e bashkëjetesës në paqe e vëllazërim midis feve dhe ushtruesve të tyre në Shqipëri, e cila është në vend një model i paqes dhe harmonisë fetare.

Mesazhet e këtyre proverbave të krijuara me aq sharmë nga autori iu drejtohet jo vetëm besimtarëve, por edhe ateistëve, gjithë atyre që kërkojnë të gjejnë të sendërtuar në pak fjalë, siç ndodh me proverbat, sa më shumë informacion, kumte, botëvështrim dhe kuptime të drejta për jetën dhe shoqërinë, sa më shumë dritë dhe dashuri njerëzore.

Kur shfleton faqet e librit "Bukuria e universit të besimit" të autorit Mevlud Buci, të duket sikur le prapa një ankth ekzistencial, pasi je zhytur në honet e antitezave dhe paradokseve të forta poetike, të krijuara me aq mençuri dhe largpamësi nga një mjeshtër i përdorimit të fjalës nëntekstuale.

Në këtë univers përvojash dhe përjetimesh të ngritura në trajtë të mirëfilltë estetike, lëvizin shpresa dhe zhgënjime, besimi dhe mirësia, karakteri njerëzor në përthyerjet dhe dritëhijet e tij, humanizmi, respekti, ligësia, ferri dhe parajsa, vëllazërimi fetar, vetë shoqëria shqiptare me një përditshmëri të sëmurë, po ku gëlon shpresa se, pas tunelit, do të duket një dritë dhe kjo është drita e besimit, të cilën autori kërkon t'ua përcjell të gjithëve.

"Bukuria e universit të besimit" është një hymn i fjalës, mendimit dhe filozofisë së kodifikuar, ku autori ka hulumtuar në përvojën vetjake dhe atë kolektive të shoqërisë shqiptare për të na dhënë modelet e funksionimit të shpirtit njerëzor, të virtytit dhe vesit, duke kurdisur zemberekun e vetë kësaj kohe të krisur.

Vëzhgimi nga ana e tij në mënyrë poetike dhe përgjithësuese i aspekteve sociologjike, psikike, etike e moral në këtë libër gërshetohet me qëndrimin e parë të autorit në favor të vlerave njerëzore, kërkimit të të cilave ai ua dedikon këtë libër. Në këto proverba fokusohen dukuritë bashkëkohore që lidhen jo vetëm me fenë dhe besimin, por dhe me marrëdhëniet e njeriut bashkëkohor me dukuritë e shpirtit si besën, mikpritjen, respektin, mirënjohjen, por nuk mungojnë dhe konsideratat për dukuritë etnokulturore e psikologjike-analitike të atyre dukurive, që i janë bashkëngjitur procesit të afirmimit të vlerave dha antivlerave, duke vënë theksin në ato kode të heshtura, të trashëguara brez pas brezi, që kanë ruajtur vetë shtyllat e ekzistencës historike të një bote dhe të një qytetërimi, që ka lënë shenja të theksuara në kohë dhe hapësirë.

Ajo që është nënvizuar është puna kolosale dhe aq pasionante e Mevlud Bucit, këtij kërkimtari të vetmuar të shpirtit dhe mendjes njerëzore, për të qëmtuar dhe përcjellë në këtë libër me aforizma një botë të trazuar ndjesish, përjetimesh, marrëdhëniesh, të cilat përshkohen nga një filozofi e epërme poetike.

Ja disa proverba të këtij libri:

I prishuri kurdoherë të prish, sepse ligësitë kudo i grish.

*

Ligësia është errësira e shpirtit njerëzor, njeriun që e ka e shndërron në meteor.

*

Dikush që nuk bën kthesë edhe pas gabimit, zhytet përherë në pellgun e mjerimit.

*

Mevlud Buci, ky usta i regjur i qëmtimit, mbledhjes dhe, në mënyrë të veçantë, i krijimit të aforizmave dhe njësive të tjera nëntekstuale të psikolinguistikës, na jep në këtë libër vetë shpirtin e tij në dorë, ftesën e hapur ndaj individit dhe shoqërisë shqiptare për të reflektuar, për të ndryshuar, për t'u përsosur, për të parë universin e besimit ku ai depërton modelin e sjelljes në jetë dhe frymëzimin e pareshtur për vepra të mira e të drejta për veten, familjen dhe kombin.

Duke lexuar këtë libër me aforizma të vijnë në mendje fjalët profetike të Volterit: "Lumturia është një gënjeshtër, dhimbja është e vërtetë". Mevlud Buci i bën një autopsi dhimbjes njerëzore, gamës së veseve dhe paranojave që e ushqejnë atë me "lëndë të parë", hipokrizisë, mashtrimit, egoizmit, smirës, falsitetit, mosmirënjohjes, komplekseve që burojnë nga e pavetëdijshmja dhe mbajnë peng vetëdijen e së mirës, duke na rekomanduar si dozë poetike kurative besimin e drejtë, besimin e vërtetë, që sjell paqen brenda shpirtit të njeriut dhe i bën raportet midis njerëzve dhe kombeve të tejdukshme.

Në thelb, ky libër është një manual poetik trandeshent, një thirrje që i bëhet njeriut bashkëkohor, vetë epokës sonë për të ndryshuar, në përputhje me thelbin e mesazheve hyjnore që kanë trokitur në ndërgjegjen kolektive njerëzore tash mijëra vjet ekzistencë dhe nuk do të reshtin kurrë së ushqyeri me shpresë brezat tanë dhe ata që do të vijnë...

** Poet, studiues, kritik arti*

Agroni thotë se ai përpiqet të përdorë poezinë e tij për të treguar histori të së kaluarës së tij dhe në lidhje me historinë e popullit të tij

Poezia – vendlindja, profesioni dhe pasioni

Shkrimtarja amerikane inkurajon poetin dibran

Nga: **BEQIR SINA**

BROOKLYN NYC : Çdo njeri prej atyre që do të lexojë këtë shkrim, i cili ka pasur një herë temën se në Nju Jork të SHBA-ve u publikua libri më i ri i poetit dibran Agron Sela me titullin "Këngë në Heshtje", do të pyes. Ky promovim! u bë një vit më parë, dhe Agroni ka shkruar vetëm një libër, me poezi, atëherë "Përse u dashka shkruar përsëri ? Përgjigjja, është se kësaj radhe nuk po shkruajnë shqiptarët, por kanë shkruar amerikanët. Gjuha me të cilën me anë poezisë, ai flet edhe me lexuesin amerikan. Libri "Kënga në heshtje" - "Songs of Silence" (Selected poems), i botuar nga shtëpia botuese Marinaj Publishing, edituar nga shkrimtari i njohur Gjekë Marinja, u botua në gjuhën angleze.

Një shkrimtare, njujorkeze Alison Blackman Dunham, autore e disa librave, pas i ka rënë në dorë ky libër, dhe e ka lexuar atë, madje duke e mësuar se kush e ka shkruar , është "çuditur" sesi një mirëmbajtës banesash, është edhe poet i talentuar. Pra, një shqiptar i thjesht, punëtor, edhe poet. Një njeri ku: "Poezia – vendlindja, familja, profesioni dhe pasioni bëhen nji"

"Shumë prej nesh bëjnë gabim që përmes lëvizjes së jetës sonë, thotë në shkrimin e saj, Alison Blackman Dunham, pa të vërtetë, mendimin e tyre lidhur me disa njerëz që bëjnë jetën tonë më të lehtë në baza ditore, e lidhin me atë pa e njohur mirë personin në fjalë. Por, në se merr në dorë këtë libër "Këngë në heshtje", gjithsesi ju do të jeni të befasuar, i habitur, në fakt, në jetën dhe talentet e këtyre njerëzve, si ky poet - Agron Sela."

Sa prej jush, për shembull, pyet ajo, në të vërtetë dinë diçka për Agronin, që punon mirëmbajtës banesash në Bruklin-NY. Unë nuk mund të them se unë në të vërtet e di se kush e njeh dhe kush nuk e njeh. Por, ju sigurojë se unë që e kam lexuar librin e tij - e shohë si një talent të lindur. Ai është një mirëmbajtës banesash në pallatin tim, është një njeri në dukje i qetë, me emrin Agron Sela.

Agroni, thotë shkrimtarja amerikane, për vite të tëra, ka mbajtur derën hapur jo vetëm për mua, por për të gjithë banorët e këtij pallati, madje edhe për mysafirët. Ai në pallat nga bujtësit shihet edhe si një kujdestar i mirë fëmijësh. Por, për të gjithë këtë konsideratë(dhe është faji im), unë dhe ne si banorë të këtij pallati, nuk kemi shkëmbyer më shumë se vetëm një pakicë fjalë të këndshme, çdo ditë teksa kemi ecur pak me mirëmbajtësin e pallatit tonë, brenda, dhe jashtë ... pa e ditur se ai është edhe një poet i talentuar.

Alison, thotë se "Ishte pak kohë, kur ai dhe një shoku tij një javë më parë, se të lexoja këtë libër, u takuan me dhe ai më pyeti nëse unë dëshiroja të lexoja diçka të shkruar prej tij. Ai si një surprizë të bukur! më ofroi një libër të vogël, me kapak të



hollë. Kur e kam shikuar në titullin : "Songs of Silence" (Selected poems), " dhe se autor ishte ... Agron Sela! mirëmbajtësi i pallatit tonë, të them të drejtën jam befasuar, jam çuditur, kaq vjet dhe nuk e kam ditur se Agroni ishte dhe poet.....

Pra, ky, është edhe një nder dhe një përgjegjësi, për të kaluar më pas në gjykimin mbi punën e dikujt. Edhe pse unë jam një autore i disa librave,(shif faqen e internetit http://www.advicesisters.net/), nuk është një nga aftësitë që kam zotëruar, të përkufizojë njerëzit. Unë, thotë ajo i admiroj të gjithë ata që mund të shkruajnë në këtë mënyrë, më të përcaktuar dhe më kompakt, në këtë formën, që ka zgjedhur, Agroni me librin me poezi "Këngë në heshtje.

Ai mu duk se shkruan me një seriozitet të madh. E mora librin t'i hedh një vështrim i shpejtë e shpejtë, faqe e në faqe, pasi e dija se Agroni do të më pyeste, menjëherë "se çfarë unë do të isha në gjendje për të thënë, për poezinë e tij." Shpejt e shpejt, lexojë e shfletojë përmes faqeve, dhe ajo që filloj për mua të më "ziej" nga brenda në shpirtin tim, është se unë po lexoja diçka shumë të veçantë, diçka që të them të drejtën për herë të parë. Pasi, këto poezi, për mua nuk ishin vetëm të mira, por ato ishin shumë të dashura dhe, të jashtëzakonshme.

Kjo, që ka ndodhur me mua, nuk ka ndodhur se Agroni ishte një poet i "madh" i cili mund të ketë "pushtet" parimor tek emocionet, por, se ai të prek thellë edhe në një frazë të thjeshtë të çdo poezie në këtë libër. Unë kam qenë e habitur!

Më pas se nisa të shkruaja këto rreshta, kam marrë librin e tij të vogël - dhe kam shkuar menjëherë lart, në banesë. Fillova të lexoj çdo gjë ishte shkruar "një e më një" deri sa arrita në fund të librit, e pikëlluar se nuk jam ndonjë njeri, që kisha shumë për të zbuluar. E mësuar edhe pak më shumë, me rrethe artistësh, edhe vetë

Një shkrimtare, njujorkeze Alison Blackman Dunham, autore e disa librave, pas i ka rënë në dorë ky libër, dhe e ka lexuar atë, madje duke e mësuar se kush e ka shkruar , është "çuditur" sesi një mirëmbajtës banesash, është edhe poet i talentuar. Pra, një shqiptar i thjesht, punëtor, edhe poet. Një njeri ku: "Poezia – vendlindja, familja, profesioni dhe pasioni bëhen nji" "Shumë prej nesh bëjnë gabim që përmes lëvizjes së jetës sonë, thotë në shkrimin e saj, Alison Blackman Dunham, pa të vërtetë, mendimin e tyre lidhur me disa njerëz që bëjnë jetën tonë më të lehtë në baza ditore, e lidhin me atë pa e njohur mirë personin në fjalë. Por, në se merr në dorë këtë libër "Këngë në heshtje", gjithsesi ju do të jeni të befasuar, i habitur, në fakt, në jetën dhe talentet e këtyre njerëzve, si ky poet - Agron Sela."

mendoja se të njëjtën gjë, po ndiente edhe Agroni.

Mësova më pas se Agroni është një vendali nga Dibra e Madhe e Maqedonisë, se ai filloi të shkruajë poezi në klasën e 5-të fillore, kur ai e mësoi poezinë në shkollë. Si student, në shkollën e mesme dhe më pas edhe në shkollën e lartë - në Universitetin e Prishtinës, në Degën Letërsi e Gjuhën shqipe, ku qëllimi i tij ishte që të bëhet një profesor i letërsisë. Megjithatë, unë mësova nga ky njeri se kur ai ishte gjatë vitit të tij të parë, në Fakultet, disa studentët e Prishtinës, filluan protestuat studentore të Universitetit të Prishtinës, kundër regjimit të ish Jugosllavisë.

Tek biografia tij, mësova, se ai dhe disa nga shokët e tij u arrestuan. Sela, nuk kishte, pas rrugë tjetër pas reprezaljes që fillojë të ushtrojë regjimi serb, ndaj shqiptarëve të Kosovës, e sidomos studentëve, njeri prej të cilëve kishte qenë dhe ai vetë. Por, mendojë thotë ajo " Ai jo nga frika, por se nuk kishte rrugë tjetër, e la vendin e tij dhe me një vizë studentore, shkoj në Gjermani."

Plani i tij ishte që të kthehej, por, kur ai ka marrë njoftimet se çfarë po ndodhte në Kosovë, dhe lexojë në një gazetë për dënimin e shokëve të tij të klasës, dhe se në gazetë përmendej edhe emrin i tij, ai e dinte se ai nuk mund të shkojë më në Prishtinë dhe as në shtëpinë e tij në Dibër të Madhe. Pasi e priste i njëjti fat, vetëm burgu.

Kështu që, ai përfundoi në një kamp të refugjatëve. Së fundi, në vitin 1983 ai fitoi të drejtën e hyrjes në Shtetet e Bashkuara. Ai jeton këtu me gruan e tij dhe katër fëmijë. Për herë të parë, në vitin 1992, Agroni ka shkuar për të për të vizituar shtëpinë e tij. Por, thotë shkrimtarja, njujorkeze Alison Blackman Dunham, autore e disa librave, kur e pyeta, Agronin, nëse ai do të donte të jetojnë përsëri atje, ai më tha: "Se

FJALA E NËNËS

Eca që në gjenezë,
Si buzëqeshja e diellit n'agim;
Dijet të gjejn' strehë,
Nëpër motet e zbehta, djal' im.
Mua, që mëkova ungjijtë,
Kush ma vodhi perëndinë?

TË SHKRETËT

Shokët e mi janë si luledielli.
Edhe pse dielli ka perënduar,
Ende e mbajnë kokën të kthyer andej.
Dritën e presin t'iu vijë pas shpine.

NË OHËR

Rrapi i Ohrit,
Kuvendon me bjeshkët e Sharrit.
Kaltërsia e liqenit përkëdhel
Kaçurrelat e pakrehura të Vardarit.

do të shkoj ta vizitojë vendin tim se më merr malli por"jo të qëndrojë atje. Koha lëvizë , tha ai, dhe unë e familja ime kemi krijuar këtu lidhje të reja," tha ai.

Agronit, duket se i "mungon shumë vendi i tij" ajo është e dukshme dhe e ndjeshme teksa lexon këtë libër me poezi të tij librin : "Këngë në heshtje", poezitë e tij janë ende të dukshme e shumë të prekshme - komplekse, politike, dhe përplot të malluar, për çdo gjë nga Kosova, Dibra e Madhe dhe Shqipëria.

Poezitë e tij janë të mbushura edhe me gëzimet dhe herë herë më të hidhurat e jetës.....

Agroni thotë se ai përpiqet të përdorë poezinë e tij për të treguar histori të së kaluarës së tij dhe në lidhje me historinë e popullit të tij (ai shkruan dhe poezi në anglisht dhe në shqip). Ai thotë se ai mësoi shumë për gjuhën e tij nga Anglishtja. Ai i pëlqen poezinë si një të mesme, sepse kjo është një formë që të gjithë mund ta kuptojnë dhe vlerësojmë. Ai nuk është frymëzuar nga një poet aq shumë i madh, se sa nga një poet që merr frymëzim nga copa të vogla jete e shumë të tjera vetëm nga vendi i tij.

Me të madhe zhurmojnë barbarët
Për andrrën me djep të zbrazët
Ku nata i ka mbathë këmbët
E dita ka nisë të zbardhet.
Bukuria në dyluftim me dreqin
Që unë të rifirmos tapinë
Për varret, token, shtëpinë...

"Agroni është një poetë që vetëm ka të shkruar shënimet e tija, parapëlqen poezinë e shkurtër sa herë që ai është i frymëzuara ose gjen kohë. "Ju vetëm duhet të gjeni kohë,të frymëzuar dhe të shkruani " tha ai butësisht. Unë jam duke shpresuar se Agron Sela, që të afirmohet një poet i vërtetë, duhet të gjej kohë shumë më të përpilojnë në të ardhmen edhe libra të tjerë me poezi. Ndërsa, libri i parë është i titulluar, "Këngë në heshtjes" Agron Sela, talentin duhet ta vëri në përdorim, ai nuk duhet të mbetet i heshtur, Nëse ju doni të zbuloni më shumë për poezinë e bukur të Agron Selës, pse nuk i lexoni ato për veten tuaj ? Merrni Librin "Këngë në heshtje" dhe i bëni vetes një dhuratë të veçantë, gjithashtu." ka konkluduar shkrimtarja, njujorkeze Alison Blackman Dunham, vetë autore e disa librave.

Agron Sela më shumë se 26 vite jeton në SHBA, pas braktisjes së vendit nga regjimi komunist, pasi që ishte student i Universitetit të Prishtinës dhe pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1981. Ky është volumi i tij i parë poetik i botuar në SHBA.

E lindur 7 vjet më parë foleja e dijes "Sarina", tashmë është kthyer në modelin e një shkolle jopublike në Shqipëri

"Sarina", aty ku fillon e ardhmja!

Nga: DEFRIM METHASANI

16 shtatori i vitit 2002 ka mbetur në historinë e shkollës jopublike "Sarina", si guri vendimtar që hodhi themelet e një ndërtese, e cila që prej asaj dite, është kthyer në një fole të dijes. Asokohe, nisma e zotit Liman Hoxha, do të ishte veçse një dëshira dhe ëndërr e një djali të ri dhe të pasionuar, që vinte nga Anglia ku kish emigruar prej kohësh, për të investuar jo në një fabrikë apo lokal, por në investimin për dijen, kulturën dhe shkollën. Një kopësht i vogël dhe ca fëmijë të bukur si dallëndyshe, u mblodhen nën çatinë e të parës godinë modeste në zemër të lagjes së njohur "Treshi", pranë shinave, në rrugën që shkon drejt Kamzës. Por njerëzit që mblodhi rreth vetes, vlerësuan këtë pasion dhe këtë mision të tij, duke punuar për së mbari, ndaj oreksi erdhi duke ngrënë e një tjetër godinë filloi së ndërtuari, tashmë shkolla e ciklit të ulet. Por puna titanike e viteve të para dhe besimi i krijuar në familjet e nxënësve të parë, solli një tjetër evolim të shtimit të numrit të klasave dhe objektivi tashme u rrit, duke kaluar edhe në arsimin 8-vjeçar atëherë, sot 9-vjeçar. Kulmi i kësaj arritje u shënua katër vjet më parë, kur u bë i mundur edhe arsimi i mesëm, madje tashmë prej një viti, ndërtesës së bukur katërkatëshe, iu bashkangjit edhe një tjetër, më moderne, që përmirësoi më tej kushtet e mësimit, por edhe argëtimit të nxënësve.

Duke patur në krah edhe një drejtues profesionist, si drejtori Besim Toçi, por edhe mësues të aftë dhe korrektë, Liman Hoxha bën të mundur që këtë sezon të kalojë shifrën e 500 nxënësve, ndërsa në gjithë vitet kjo shifër shkon mbi 1100. Të tillë numra, ndoshta flasin edhe më shume se komentet, apo radhët e shkrimit. Në kohë të tilla, të fitosh besimin e njerëzve, vërtet që është e vështirë, por një staf i tillë dhe një model në organizim, bën të mundur këtë mrekulli. 25 klasa dhe mbi 500 nxënës, pa harruar edhe 40 parashkollorët, janë sot vlerësimi më i mirë që mund të bëhet për një shkollë jopublike, ku prindërit paguajnë për të arsimuar fëmijët. Nga bangat e kësaj shkolle kanë dalë edhe fitues të olimpiadava kombëtare të matematikës, siç ka ndodhur në vitin 2007, me Taulant Prençin, që zuri vendin e parë, apo vendi i tretë në Republikë me nxënësit Ekzon Çakrri dhe Gëzim Muslia. Për tu veçuar në arritjet e këtyre viteve edhe paraqitja e jashtëzakonshme e maturantit Gerald Osmani, që është renditur në 10-të nxënësit më të mirë në shkallë vendi, falë rezultateve të arritura. Aktualisht, në shkollën jopublike "Sarina", ka 34 mësues, që përfaqësojnë nivele dhe gjeografi të larmishme, ndërkaq që tre nga më të mirët, janë në komandën e zv.drejtorit, sipas cikleve. Kështu, parashkollerët drejtohen nga Viktor Gjini, 9-veçaret nga Miftar Veliu dhe arsimi i mesëm nga Shkëlqim Salillari. Veprimtaritë jashtëshkollore kanë qenë një tjetër objektiv dhe realitet i prekshem, që është përjetuar në aspektin sportiv, kulturore dhe shkencore. Madje një nga kulmet sportive, ka qene kupa "Panajot Pano", zhvilluar në mjediset sportive të kësaj shkolle, aty ku u mblodhën qindra e mijëra fansa të lojës magjike, por edhe të "Mjeshtrit të Madh", Pano, të ardhur edhe nga shkollat e tjera publike dhe jo të tilla. Mbreti i futbollit mbeti i shtangur nga disiplina, rregulli, por edhe dëshira e pasioni i mësuesve dhe nxënësve, gjë që e shprehu edhe në emisionet televizive dhe në një intervistë të dhënë për Radio Televizionin Shqiptar.

Një tjetër arritje në performancën dhe mënyren e realizmit të saj, ka qenë edhe festa e të parës maturë që doli nga bangat e kësaj shkolle në verën e vitit 2009, feste kjo që mbeti si një nga kujtimet me të bukura, jo vetëm për protagonistet që u ndanë të përmallur nga njëri-tjetri, por edhe tek të pranishmit. Askush nuk e priste që maturantët e parë të kësaj shkolle të prezantoheshin sikur ishin yjet e "Hollivudit", përmes atij spektakli fantastik, duke marrë me vete më shumë kujtime se ndoshta e gjithë koha e qëndrimit të tyre bashkë. Ky ishte një vlerësim, jo vetëm për ata, por edhe për maturën e parë, që kaloi me sukses një test jo të lehtë. Ndërkaq, pritet që ky fundvit, të sjellë një tjetër ngjarje spektakolare, sepse do të vlerësohen edhe 10 më të mirët e shkollës, përmes një veprimtarie kulturore, e cila do të zgjojë mjaft interesin e nxënësve, por edhe justifikon impenjimin e gjithë stafit dhe administratorit Liman Hoxha, për të bërë më të mirën e mundshme në shërbim të tyre. Madje e njëjta traditë do të vazhdojë edhe në mbyllje të çdo viti mësimor, aty ku si në një paradë artistike do të parakalojnë më të mirët, përmes vlerësimit moral, por edhe material që do t'iu bëhet nga stafi drejtues i "Sarinës".

> "Sarina" është kthyer në një vatër edukuese dhe emancipuese, në një fole të dijes, që nuk shton vetëm numrin e fëmijëve, por edhe formimin dhe prestigjin e tyre.

> Zbatimi më përpikmëri i orarit, niveli i mësimdhënies, lëvizja e organizuar me furgonët e transportit, kabinetet e reja, salla e kompjuterave, fushat e futbollit, volejbollit, lojërave të tjera, pikat ambulante, apo ajo e urgjencës, janë një tjetër fakt që krijon përshtypjen e një shkollë të sigurtë, vizionare dhe të përparuar. Edhe kontrollet e drejtorisë arsimore, apo Ministrisë së Arsimit, kanë rezoltuar të suksshme, madje shpesh herë janë marrë edhe si modele të punës për simotrat e saj...

Një tjetër dukuri që natyrisht ka krijuar besimin në këtë shkollë është edhe garancia dhe disiplina. Shprehja e administratorit të shkollës Hoxha, se nuk me vlen leku, apo paraja e një të padisiplinuari, apo problematiku, është domethënëse. Zbatimi më përpikmëri i orarit, niveli i mësimdhënies, lëvizja e organizuar me furgonët e transportit, kabinetet e reja, salla e kompjuterave, fushat e futbollit, volejbollit, lojërave të tjera, pikat ambulante, apo ajo e urgjencës, janë një tjetër fakt që krijon përshtypjen e një shkollë të sigurtë, vizionare dhe të përparuar. Edhe kontrollet e drejtorisë arsimore, apo Ministrisë së Arsimit, kanë rezoltuar të suksshme, madje shpesh herë janë marrë edhe si modele të punës për simotrat e saj, disa prej të cilave edhe janë mbyllur.

Tashme aty nuk ka më vend për reklamë, sepse reklama më e mirë janë ata që vazhdojnë procesin mësimor në bangat e kësaj shkolle. Unë jam njëri prej atyre prindërve, që fillimisht kam qenë pesimist me atë çfarë flitej për arsimin privat në Shqipëri. Por, para tre vjetësh edhe opinioni im ka ndryshuar dhe sot vajza ime Lunada, është në vitin e tretë të kësaj shkolle, ndërsa edhe tjera, mezi pret të mbarojnë vitin shkollor, për t'iu bashkangjitur arsimit të mesëm atje. Si vajzat e mia ka shumë, natyrisht të paimponuara nga askush, por të motivuara me atë çfarë realisht kanë përjetuar motrat, vëllezërit, apo njerëzit e afërm. Të fitosh besimin e tjetrit sot në të tilla kohë të vështira, natyrisht nuk është e lehtë, madje tepër e vështirë, por përmes punës, nivelit të mësimdhënies, dijeve të transmetuara, korrektesës morale dhe profesionale, çdo gjë ndodh dhe nuk ka asgjë të pamundur. Tashme ky besim i krijuar mbetet të mos shpërdorohet, por të ngurtësohet, si themelet e kësaj ndërtese, e cila ka krijuar profilin e saj, atë profil që nuk ka qenë e lehtë të ishte. "Sarina", tashme është kthyer në një vatër edukuese dhe emancipuese, në një fole të dijes, që nuk shton vetëm numrin e fëmijëve, por edhe formimin dhe prestigjin e tyre. Shumë njerëz flasin dhe thonë për gjëra që iu mungojnë, ndërsa unë vendosa të flas e shkruaj sot, për diçka që e shoh çdo ditë, që e prek çdo çast, sepse aty kam besuar gjënë më të shtrenjtë, vajzën, e cila sot me vjen mire që renditet tek ai brez i të talentuarve dhe përparuarve të kësaj shkolle, që rritet përditë, jo vetëm me katet e shtuara, por edhe me afirmimin dhe besimin e të tjerëve...

Gazetën, falë ndihmës së z. Gazmend Kërkuti, mund ta lexoni edhe në internet në adresën: www.dibra.org